Република Северна Македонија
Министерство за образование и наука

Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Arsimit dhe Shkencës

МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА - БИРО ЗА РАЗВОЈ НА ОБРАЗОВАНИЕТО
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS - BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE - BUREAU FOR DEVELOPMENT OF EDUCATION

KONCEPTI PËR ZBULIMIN DHE PUNËN ME NXËNËSIT E TALENTUAR DHE TË DHUNTISHËM

NË ARSIMIN FILLOR

Shkup, 2026

Koncepti i identifikimit dhe punës me nxënës të talentuar dhe të dhuntishëm në arsimin fillor u miratua me vendim nr. **12-13802/2 më 05.11.2026**

Koncepti për identifikimin dhe punën me nxënësit e talentuar dhe të dhuntishëm në arsimin fillor është hartuar nën bashkërenditjen e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, nga një grup pune i formuar me vendim të drejtores së Byrosë së Zhvillimit të Arsimit.

Në procesin e hartimit dhe përgatitjes profesionale të këtij dokumenti kanë kontribuar ekspertë nga institucione të ndryshme, përkatësisht: Byroja e Zhvillimit të Arsimit; Universiteti ”Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup; Fakulteti i Pedagogjisë në Manastir, pranë Universitetit ”Shën Klimenti i Ohrit; Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut si dhe shoqatat e mësimdhënësve të akreditуar.

Koncepti është finalizuar pas zhvillimit të një procesi konsultimi publik, gjatë të cilit janë shqyrtuar dhe integruar komentet dhe sugjerimet e paraqitura nga institucionet përkatëse, komuniteti profesional dhe palët e tjera të interesuara.

PËRMBAJTJE

I. HYRJE DHE BAZAT PËR HARTIMIN E KONCEPTIT 5

I.1. Bazat kombëtare për hartimin e Konceptit ... 5

I.2. Nevoja për qasje sistematike ndaj dhuntisë dhe talentit ... 6

I.3. Gjendja dhe nevojat në arsimin fillor ... 6

I.4. Bazat shkencore dhe ndërkombëtare ... 8

I.5. Përcaktimet themelore të modelit maqedonas ... 9

II. KORNIZA TERMINOLOGJIKE DHE KONCEPTUALE ... 10

II.1. Dhuntia dhe talenti ... 10

II.2. Natyra zhvillimore dhe shumëdimensionale ... 10

II.3. Fushat e shfaqjes ... 11

II.4. Shfaqja e potencialit të lartë në procesin edukativo-arsimor ... 11

II.5. Profile të ndryshme të nxënësve të talentuar dhe të dhuntishëm ... 12

III. VLERAT DHE PARIMET ... 13

IV. NJOHJA DHE IDENTIFIKIMI I NXËNËSVE TË TALENTUAR DHE TË DHUNTISHËM ... 15

IV.1. Qëllimi dhe vendosja konceptuale ... 15

IV.2. Parimet e njohjes dhe identifikimit ... 17

IV.3. Fazat, procedurat, burimet dhe bartësit e procesit ... 18

IV.4. Nxënësit te të cilët potenciali identifikohet më vështirë ... 21

IV.5. Rezultatet, dokumentacioni, mekanizmat mbrojtës dhe parakushtet sistemore ... 21

V. MASAT DHE AKTIVITETET PËR PUNËN EDUKATIVO-ARSIMORE ME NXËNËSIT E TALENTUAR DHE TË DHUNTISHËM ... 23

V.1. Qëllimi dhe vendosja e masave dhe aktiviteteve ... 23

V.2. Masat në kuadër të mësimit të rregullt ... 24

V.3. Mundësi të zgjeruara brenda dhe jashtë shkollës ... 26

V.4. Garat, manifestime dhe prezantimi publik i arritjeve ... 26

V.5. Planifikimi individual, mentorimi dhe mbështetja socio-emocionale ... 27

V.6. Përparimi i përshpejtuar ... 28

V.7. Nxitja, shpërblimet dhe bursat ... 29

V.8. Dokumentet profesionale dhe kushtet për zbatim 31
VI. MENAXHIMI, ROLET DHE PËRGJEGJËSITË 32
VI.1. Ekipi i shkollës dhe bashkërenduesi për nxënësit e talentuar dhe të dhuntishëm 32
VI.2. Dokumentacioni, evidenca dhe mbrojtja e të dhënave 36
VII. TRANZICIONI DHE VAZHDIMËSIA E MBËSHTETJES 37
VII.1. Përcaktimi fillestar 37
VII.2. Parimet e vazhdimësisë 37
VII.3. Vazhdimësia gjatë arsimit fillor 37
VII.4. Kalimi në arsimin e mesëm 38
VII.5. Vazhdimësia e mbështetjes për nxënësit që përballen me rrezik më të madh për të mos u identifikuar 38
VII.6. Rolet dhe përgjegjësitë 38
VII.7. Ndjekja e vazhdimësisë 38
VIII. NDJEKJA, VLERËSIMI DHE RAPORTIMI 40
VIII.1. Korniza dhe treguesit për ndjekje 40
VIII.2. Ndjekja dhe vetëvlerësimi në nivel shkolle 41
VIII.3. Ndjekja dhe vlerësimi në nivel sistemik 42
VIII.4. Raportimi kombëtar dhe shfrytëzimi i rezultateve 43
SHTOJCA 1. DOKUMENTET SHOQËRUESE PËR ZBATIMIN E KONCEPTIT 44
PARAQITJA GRAFIKE E PROCESIT TË PLOTË 48

I. HYRJE DHE BAZAT PËR HARTIMIN E KONCEPTIT

I.1. Bazat kombëtare për hartimin e Konceptit

Hartimi i Konceptit mbështetet në kuadrin ligjor, strategjik dhe konceptual të arsimit fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në përvojat e deritanishme kombëtare, si dhe në njohuritë bashkëkohore shkencore dhe profesionale për zhvillimin dhe edukimin e nxënësve të talentuar dhe të dhuntishëm.

Baza e drejtpërdrejtë ligjore është Ligji për Arsimin Fillor, i cili, ndër qëllimet e arsimit fillor, përcakton edhe mbështetjen e nxënësve/nxënëseve të talentuar dhe të dhuntishëm në fusha të ndryshme. Në përputhje me nenin 34, paragrafin (1), ministri, me propozim të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, miraton Konceptin për identifikimin dhe punën me nxënësit e talentuar dhe të dhuntishëm, ndërsa paragrafi (4) përcakton se me të rregullohen njohja dhe identifikimi i tyre, si dhe masat dhe aktivitetet për punën me ta. Koncepti respekton terminologjinë ligjore, ndërsa trajtimin e nocioneve të dhuntisë dhe talentit, si dhe të zhvillimit të tyre, e mbështet në njohuritë bashkëkohore shkencore dhe profesionale. Në këtë mënyrë, kjo fushë përcaktohet si pjesë përbërëse e sistemit të arsimit fillor dhe jo thjesht si veprimtari e rastësishme e shkollave të veçanta.[1]

Baza më e gjerë strategjike përcaktohet me Strategjinë e arsimit 2026–2032 me Planin aksional 2026–2028, e cila, në fushën prioritare ”Arsimi fillor:, e ndërlidh përparimin e cilësisë së mësimdhënies me qasjet e diferencuara dhe të individualizuara, si dhe me krijimin e një sistemi për identifikimin, mbështetjen dhe nxitjen e nxënësve të talentuar. Koncepti e shtjellon këtë përcaktim strategjik përmes një kornize kombëtare për njohjen, identifikimin dhe mbështetjen e vazhdueshme edukativo-arsimore.[2]

Koncepti ndërlidhet edhe me përcaktimet e Planit strategjik të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës 2026–2028 dhe të Programit të punës së Qeverisë 2024–2028, në të cilat parashikohet zhvillimin e sistemit për njohjen dhe mbështetjen e nxënësve të talentuar dhe të dhuntishëm, përmirësimi i punës edukativo-arsimore, mentorimi, ndërlidhja me burimet dhe institucionet e jashtme, si dhe mbështetja e nxënësve, mësimdhënësve dhe familjeve.[3,4]

Koncepti i arsimit fillor përbën bazën e drejtpërdrejtë konceptuale për këtë dokument. Përcaktimet e tij për arsimin me nxënësin/nxënësen në qendër, barazinë, drejtësinë, gjithëpërfshirjen, respektimin e dallimeve individuale, zhvillimin e kompetencave dhe krijimin e mundësive për përparim në përputhje me aftësitë dhe interesat përbëjnë gjithashtu bazë për rregullimin sistematik të punës me nxënësit/nxënëset e talentuar dhe të dhuntishëm.[5]

Standardet kombëtare për arritjet e nxënësve/nxënëseve në fund të arsimit fillor e orientojnë procesin edukativo-arsimor drejt zhvillimit të njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave në fusha të ndryshme.

---

[1] Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2019). *Ligji për Arsimin Fillor*. ”Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 161/2019, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Neni 34.

[2] Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2026). *Strategjia e Arsimit 2026–2032* me Planin aksional 2026–2028. Fusha prioritare ”Arsimi fillor”, masa 2.6.

[3] Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2025). *Plani strategjik i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës* 2026–2028. Nr. 01-16397/1, m; 26.12.2025.

[4] Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2024). *Programi i Punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut* 2024–2028.

[5] Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byroja e Zhvillimit të Arsimit. (2021). *Koncepti i arsimit fillor.*

Shtrirja e tyre e gjerë është e rëndësishme edhe për kuptimin e dhuntisë dhe talentit, pasi potencialet mund të shfaqen në fusha të ndryshme dhe nuk identifikohen vetëm nëpërmjet notave ose arritjeve në lëndë të veçanta mësimore.[6]

Bazë e rëndësishme është edhe Koncepti për arsimin gjithëpërfshirës, veçanërisht përcaktimi që sistemi arsimor t'i njohë nevojat e ndryshme të nxënësve dhe të sigurojë kushte për pjesëmarrjen, të nxënit dhe përparimin e tyre. Në këtë kuptim, mbështetja e nxënësve të talentuar dhe të dhuntishëm është pjesë përbërëse e sistemit që respekton dallimet individuale dhe krijon kushte që secili nxënës ta zhvillojë potencialin e vet.[7]

Koncepti ndërlidhet edhe me ligjet dhe aktet nënligjore që rregullojnë kompetencat profesionale dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe drejtorëve, veprimtarinë profesionale dhe zhvillimore të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, cilësinë e punës edukativo-arsimore, si dhe përcjelljen dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve dhe të punës së shkollave.

Në këtë mënyrë, nuk krijohet një sistem i veçantë ose paralel, por bëhet avancimi i sistemit ekzistues të arsimit fillor dhe ndërlidhja e mekanizmave të tij ligjorë, strategjikë, programorë dhe profesionalë në një kuadër funksional për njohjen dhe zhvillimin e potencialeve të nxënësve.

I.2. Nevoja për qasje sistematike ndaj dhuntisë dhe talentit

Çdo nxënës duhet të ketë mundësi t'i zhvillojë aftësitë dhe potencialet e veta deri në nivelin më të lartë që mund të arrijë. Kjo nënkupton që sistemi arsimor t'i njohë dallimet individuale dhe të sigurojë kushte dhe mbështetje të përshtatshme edhe për nxënësit që shfaqin potencial të lartë, aftësi të theksuara, interesa, kreativitet ose arritje në një apo më shumë fusha.

Dhuntia dhe talenti janë dukuri komplekse dhe zhvillimore. Ato nuk shfaqen në të njëjtën mënyrë te të gjithë nxënësit/nxënëset dhe as nuk janë njësoj të dukshme në të gjitha periudhat e zhvillimit dhe situatat arsimore. Te disa nxënës/nxënëse, potencialet e larta shfaqen herët përmes përparimit të shpejtë ose arritjeve të larta, ndërsa te të tjerët mund të mbeten të padukshme për një kohë më të gjatë. Te i njëjti nxënës potenciali mund të jetë i dukshëm në një fushë, ndërsa në një fushë tjetër të mos njihet sa duhet. Shfaqja e tyre varet nga karakteristikat individuale të nxënësit, por edhe nga mundësitë për të nxënë, mbështetja dhe përvojat që i ofrohen.

Për këtë arsye, njohja e tyre nuk kufizohet në një testim të vetëm, sukses të lartë shkollor ose rezultat në gara. Nevojitet një proces i vazhdueshëm, gjatë të cilit potencialet vërehen në situata të ndryshme, përcillen me kalimin e kohës dhe shqyrtohen përmes burimeve të shumta të informacionit dhe formave të ndryshme të veprimtarisë.

Në këtë Koncept, zbulimi kuptohet si një proces më i gjerë dhe i vazhdueshëm zhvillimor, i cili përfshin njohjen, krijimin e mundësive për shfaqjen dhe zhvillimin e potencialit, përcjelljen e përparimit dhe identifikimin mbi bazën e kritereve të shumta. Identifikimi nuk përbën qëllim në vetvete, por bazë për planifikimin dhe sigurimin e mbështetjes së përshtatshme edukativo-arsimore.

I.3. Gjendja dhe nevojat në arsimin fillor

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekzistojnë baza ligjore dhe konceptuale, si dhe hulumtime kombëtare dhe përvoja profesionale që lidhen me njohjen dhe mbështetjen e nxënësve të talentuar dhe të dhuntishëm.

[6] Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byroja e Zhvillimit të Arsimit. (2021). *Standardet kombëtare për arritjet e nxënësve në fund të arsimit fillor.* Vendimi nr. 08-4176/2, datë 5.3.2021.

[7] Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byroja e Zhvillimit të Arsimit. (2020). *Koncepti për arsimin gjithëpërfshirës.*

Është e nevojshme që ato të ndërlidhen në një model të zbatueshëm, i cili do të sigurojë qëndrueshmëri dhe vazhdimësi të mbështetjes në të gjitha shkollat fillore.

Në praktikën ekzistuese, dhuntia shpesh barazohet me notat e larta, shpërblimet dhe rezultatet në gara. Këto arritje mund të jenë tregues të rëndësishëm, por nuk janë të mjaftueshme për njohjen e të gjithë nxënësve me potencial të lartë. Është e nevojshme që sistemi t'i njohë edhe nxënësit, aftësitë e të cilëve shfaqen përmes zgjidhjes origjinale të detyrave, kreativitetit, interesave të thelluara, përvetësimit të shpejtë dhe ndërlidhjes së njohurive, kureshtjes hulumtuese ose treguesve të tjerë përkatës.

Puna me nxënësit e talentuar dhe të dhuntishëm nuk duhet të kufizohet vetëm në mësimin shtesë, gara dhe aktivitete jashtë mësimit të rregullt. Mbështetja fillon në procesin e rregullt edukativo-arsimor, përmes përshtatjes së përmbajtjeve, metodave, detyrave, ritmit dhe shkallës së ndërlikueshmërisë, si dhe përmes krijimit të mundësive për nxënie të pavarur, të bazuar në zgjidhjen e detyrave dhe në hulumtim.

Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet nxënësve/nxënëseve, potencialet e të cilëve/ cilave mund të mbeten të panjohura për shkak të rrethanave sociale, ekonomike, kulturore, gjuhësore, zhvillimore ose rrethanave të tjera, si dhe nxënësve/nxënëseve te të cilët/të cilat aftësitë e larta shfaqen njëkohësisht me vështirësi në të nxënë, aftësi të kufizuara ose nevoja të tjera arsimore. Sistemi duhet të sigurojë mundësi të ndryshme që nxënësi/nxënësja ta shfaqë potencialin e vet, si dhe mbështetje të përshtatshme para dhe pas identifikimit.

Prandaj, lind nevoja për një kornizë kombëtare që do të sigurojë parime të përbashkëta, role dhe përgjegjësi të qarta, vazhdimësi të mbështetjes dhe bazë profesionale për zhvillimin e protokolleve, instrumenteve dhe materialeve për zbatim praktik.

I.4. Bazat shkencore dhe ndërkombëtare

Gjatë hartimit të Konceptit merren parasysh njohuritë bashkëkohore shkencore dhe përvojat përkatëse ndërkombëtare në fushën e dhuntisë dhe zhvillimit të talentit. Ato sugjerojnë braktisjen e kuptimit të ngushtë, sipas të cilit dhuntia barazohet vetëm me inteligjencën e përgjithshme të lartë, dhe vendosjen e një qasjeje zhvillimore që ndërlidh aftësitë, kreativitetin, motivimin, mundësitë për të nxënë dhe ndikimin e mjedisit.

Bazë shkencore e Konceptit janë kuptimi shumëdimensional i dhuntisë si ndërveprim i aftësive të përgjithshme dhe/ose specifike mbi mesataren, kreativitetit dhe përkushtimit ndaj detyrës (Xhozef Renzulli); dallimi ndërmjet potencialit të lindur dhe talentit të zhvilluar në mënyrë sistematike (Fransoa Ganje); si dhe qasja zhvillimore, sipas së cilës kalimi nga potenciali në arritje të larta kërkon kohë, mundësi të përshtatshme, mbështetje profesionale dhe forma të ndryshme të të nxënit (Rena Subotnik, Paula Olshevski-Kubilius dhe Frenk Vorell). Këto njohuri shërbejnë si bazë shkencore, pa u mbështetur në një përkufizim, model ose prag të përcaktuar paraprakisht për identifikim.[8]

Përvojat ndërkombëtare tregojnë se sistemi i qëndrueshëm ndërlidh njohjen e hershme dhe të vazhdueshme, identifikimin mbi bazën e kritereve të shumta, mbështetjen në mësimin e rregullt, planifikimin e individualizuar, mentorimin, përfshirjen e burimeve të jashtme profesionale dhe përcjelljen e përparimit. Këto përvoja përshtaten me kornizën ligjore, organizimin e arsimit fillor, kompetencat institucionale dhe burimet profesionale në dispozicion në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

[8] Renzulli, J. S. (1978). What makes giftedness? Reexamining a definition. *Phi Delta Kappan, 60*(3), 180–184, 261. Gagné, F. (2004). Transforming gifts into talents: The DMGT as a developmental theory. *High Ability Studies, 15*(2), 119–147. https://doi.org/10.1080/1359813042000314682 Subotnik, R. F., Olszewski-Kubilius, P., & Worrell, F. C. (2011). Rethinking giftedness and gifted education: A proposed direction forward based on psychological science. *Psychological Science in the Public Interest, 12*(1), 3–54. https://doi.org/10.1177/1529100611418056

I.5. Përcaktimet themelore të modelit maqedonas

Me këtë Koncept përcaktohet baza për një model zhvillimor, të drejtë, shumëkriterial dhe sistematik të zbulimit dhe punës me nxënësit e talentuar dhe të dhuntishëm. Modeli niset nga potenciali i nxënësit dhe nga nevoja që ai të njihet me kohë, të nxitet dhe të zhvillohet, pa kategorizim të parakohshëm ose të përhershëm. Procesi ka karakter të vazhdueshëm dhe fleksibil dhe zhvillohet gjatë gjithë arsimit fillor. Njohja dhe identifikimi nuk kufizohen vetëm për një moshë, klasë ose moment të caktuar, pasi potencialet mund të bëhen të dukshme dhe të zhvillohen në periudha dhe situata të ndryshme arsimore.

Identifikimi mbështetet në ndërlidhjen e disa kritereve, metodave dhe burimeve të informacionit në kuadër të një vlerësimi tërësor profesional. Asnjë tregues i veçantë nuk përbën bazë të pavarur për identifikim.

Modeli mbështetet në një qasje të koordinuar dhe multidisiplinare. Mësimdhënësit, bashkëpunëtorët profesionalë, drejtori, ekipi i shkollës për nxënësit e talentuar dhe të dhuntishëm, si dhe profesionistët e tjerë përkatës, kanë role të ndryshme, por të ndërlidhura ndërmjet tyre. Prindërit, përkatësisht kujdestarët, janë partnerë dhe burim i rëndësishëm informacioni, ndërsa nxënësi, në përputhje me moshën dhe pjekurinë, merr pjesë në planifikimin dhe ndjekjen apo monitorimin e të nxënit dhe zhvillimit të vet.

Baza e mbështetjes është mësimi i rregullt, i përshtatur me potencialet dhe nevojat e nxënësit/nxënëses. Ai zgjerohet përmes aktiviteteve shkollore dhe jashtëmësimore, mentorimit dhe bashkëpunimit me profesionistë dhe institucione të jashtme, në përputhje me masat dhe aktivitetet e shtjelluara në kapitullin V.

Mbështetja planifikohet sipas profilit individual dhe nevojave të nxënësit dhe përshtatet në përputhje me përparimin, interesat dhe nevojat e tij zhvillimore. Efektet e saj përcillen dhe vlerësohen vazhdimisht, ndërsa njohuritë e fituara nga përcjellja shfrytëzohen për planifikimin dhe përshtatjen e mëtejshme.

Drejtësia është një përcaktim përbërës i modelit. Vëmendje e veçantë u kushtohet nxënësve, potenciali i lartë i të cilëve mund të mbetet i fshehur për shkak të kushteve të pafavorshme, veçorive kulturore ose gjuhësore, vështirësive në të nxënë ose në zhvillim, motivimit të pamjaftueshëm apo arritjeve më të ulëta shkollore. Rrethanat në të cilat nxënësi/nxënësja rritet dhe mëson nuk duhet të përbëjnë pengesë për njohjen dhe zhvillimin e potencialit të tij.

Koncepti përcakton orientimet kombëtare, funksionet themelore të sistemit dhe kornizën për ndarjen e përgjegjësive. Instrumentet konkrete, testet, shkallët, kriteret, formularët dhe procedurat e hollësishme zhvillohen përmes dokumenteve profesionale shoqëruese. Para zbatimit të tyre të rregullt, çështjet që krijojnë të drejta, detyrime, autorizime, evidenca formale, pasoja juridike ose implikime financiare të reja rregullohen me akte përkatëse ligjore dhe nënligjore.

II. KORNIZA TERMINOLOGJIKE DHE KONCEPTUALE

II.1. Dhuntia dhe talenti

Koncepti e përdor shprehjen ”nxënësit e talentuar dhe të dhuntishëm“, në përputhje me terminologjinë ligjore, duke përfshirë me të nxënësit që kanë aftësi ose arritje të larta të theksuara, si dhe ata tek të cilët është njohur një potencial i lartë, i cili ende nuk është zhvilluar ose shfaqur plotësisht. Njohja është vëzhgim i vazhdueshëm pedagogjik i treguesve; identifikimi është procedurë e strukturuar profesionale, e bazuar në disa kritere; profili është përshkrim i integruar i aftësive dhe nevojave; ndërsa mbështetja përfshin masat dhe aktivitetet për zhvillimin e potencialit. Këto nocione shërbejnë për planifikimin e mbështetjes dhe jo për kategorizimin ose renditjen e përhershme të nxënësve.

Dhuntia dhe talenti janë dukuri komplekse, shumëdimensionale dhe zhvillimore, që burojnë nga ndërveprimi i aftësive, kreativitetit, motivimit, interesave, karakteristikave personale, mundësive për të nxënë dhe mbështetjes nga mjedisi. Në këtë Koncept, shprehja ”potencial i lartë” përdoret në kuptim përshkrues për aftësitë dhe mundësitë zhvillimore që mund të shfaqen dhe të zhvillohen përtej nivelit të zakonshëm të pritshëm për moshën dhe përvojat e nxënësit ajo nuk përbën kategori të veçantë juridike ose përcaktim të paracaktuar.

Dhuntia kuptohet si potencial i theksuar në një ose më shumë fusha, i cili i mundëson nxënësit/nxënëses të mësojë, të kuptojë, të krijojë, të zgjidhë detyra komplekse, të realizojë performanca dhe arritje ose të përparojë në mënyrë dhe me ritëm që dallojnë nga ato që zakonisht priten nga nxënësit me moshë, përvoja dhe mundësi të krahasueshme për të nxënë.

Talenti i referohet nivelit të lartë të zhvilluar dhe të dukshëm të njohurive, shkathtësive, kompetencës, aftësive krijuese ose arritjeve në një fushë të caktuar. Ai zhvillohet mbi bazën e potencialeve të nxënësit/nxënëses, përmes të nxënit, ushtrimit, përvojës, motivimit, përkushtimit dhe mbështetjes së përshtatshme.[9]

Shndërrimi i potencialit në talent të zhvilluar ndikohet nga faktorë intrapersonalë, si motivimi, këmbëngulja, vetëbesimi, vetërregullimi dhe pavarësia, si dhe nga faktorë të mjedisit, ndër të cilët përfshihen familja, mësimdhënësit, bashkëmoshatarët, mundësitë për të nxënë dhe burimet në dispozicion.

Zhvillimi i talentit mbështetet përmes mundësive të përshtatshme për të nxënë dhe pjesëmarrjes aktive të nxënësit/nxënëses. Iniciativa, përpjekja dhe vetërregullimi i tij zhvillohen përmes ndërveprimit me mbështetjen e familjes, shkollës dhe mjedisit më të gjerë.

Dallimi ndërmjet dhuntisë si potencial dhe talentit si kompetencë ose arritje e zhvilluar ka funksion analitik dhe zhvillimor dhe nuk nënkupton ndarjen e tyre të prerë. Ato janë pjesë e një procesi të vetëm, në të cilin potencialet, nën ndikimin e faktorëve personalë dhe të mjedisit, mund të zhvillohen në nivele të larta të kompetencës, krijimtarisë dhe arritjeve.

II.2. Natyra zhvillimore dhe shumëdimensionale

Dhuntia dhe talenti nuk janë veti të pandryshueshme, të përcaktuara njëherë e përgjithmonë. Ndryshimet në mundësitë për të nxënë, si dhe në kushtet personale dhe të mjedisit, mund të ndikojnë në shfaqjen dhe zhvillimin e tyre. Për këtë arsye, njohuritë për potencialin dhe nevojat e nxënësit plotësohen dhe rishqyrtohen periodikisht.

[9] Gagné, F. (1991). Toward a differentiated model of giftedness and talent. In N. Colangelo & G. A. Davis (Eds.), *Handbook of gifted education* (pp. 65–80). Allyn & Bacon.

Nxënësi/nxënësja mund të shfaqë potencial të lartë në një ose më shumë fusha, ndërsa zhvillimi i tij/saj kognitiv, emocional, social dhe psikomotor mund të zhvillohet me ritme të ndryshme. Për këtë arsye, profili i nxënësit nuk përcaktohet përmes një liste të vetme karakteristikash, por përmes shqyrtimit tëtërësishëm të aftësive, interesave, mënyrave të të nxënit, motivimit, kreativitetit, arritjeve, mirëqenies dhe nevojave arsimore në kontekstin konkret zhvillimor dhe shoqëror.[10]

II.3. Fushat e shfaqjes

Dhuntia dhe talenti mund të shfaqen në fusha të ndryshme dhe të ndërlidhura ndërmjet tyre: aftësitë e përgjithshme intelektuale dhe akademike; shprehja gjuhësore dhe letrare; matematika, shkencat natyrore dhe teknologjia; informatika dhe krijimtaria digjitale; fushat shoqërore dhe humanistike; veprimtaria muzikore, figurative, skenike dhe veprimtari të tjera artistike; aftësitë teknike, praktike dhe inovative; aftësitë sportive dhe psikomotorike; kreativiteti, sipërmarrësia dhe lidershipi, si dhe fusha të tjera në të cilat nxënësi/nxënësja shfaq potencial, interes ose arritje të theksuara.

Fushat e përmendura nuk përbëjnë një klasifikim të mbyllur dhe as bazë për ndarjen e prerë ndërmjet dhuntisë dhe talentit. Potenciali mund të shfaqet në mënyrë ndërdisiplinore, të përfshijë disa aftësi dhe fusha (dhunti e shumëfishtë), si dhe të ndryshojë e të zhvillohet në varësi të moshës, përvojave dhe mundësive që i ofrohen nxënësit/nxënëses.

II.4. Shfaqja e potencialit të lartë në procesin edukativo-arsimor

Në procesin edukativo-arsimor, potenciali i lartë mund të shfaqet përmes përvetësimit më të shpejtë dhe më të lehtë të njohurive dhe shkathtësive; nevojës për më pak përsëritje; kuptimit të thelluar dhe ndërlidhjes së nocioneve; arsyetimit të avancuar dhe zbatimit të strategjive komplekse për zgjidhjen e detyrave; ideve, pyetjeve, zgjidhjeve ose produkteve krijuese origjinale; interesit afatgjatë dhe të thelluar; pavarësisë, këmbënguljes dhe motivimit të brendshëm të theksuar; shkathtësisë praktike ose arritjeve që tejkalojnë dukshëm pritshmëritë e zakonshme zhvillimore dhe arsimore.

Treguesit interpretohen në raport me nxënësit/nxënëset e së njëjtës moshë ose të moshës së përafërt, por edhe duke marrë parasysh përvojat e mëparshme të krahasueshme, kushtet gjuhësore dhe kulturore, si dhe mundësitë për shfrytëzimin e burimeve përkatëse arsimore. Në këtë mënyrë shmanget interpretimi i dallimeve sociale, ekonomike, gjeografike ose dallimeve të tjera në mundësitë e ofruara si dallime në potencial.

Karakteristikat dhe treguesit e potencialit të lartë nuk janë domosdoshmërisht të pranishëm te çdo nxënës dhe as nuk shfaqen me intensitet të njëjtë në çdo situatë. Në dukshmërinë e tyre mund të ndikojnë mosha, veçoritë socio-emocionale, mjedisi gjuhësor dhe kulturor, mundësitë e mëparshme për të nxënë, aftësia e kufizuar ose vështirësitë në të nxënë, kushtet familjare dhe sociale, si dhe pritshmëritë e mjedisit.

Suksesi i lartë shkollor, në vetvete, nuk përbën tregues të mjaftueshëm të dhuntisë ose talentit. Njëkohësisht, arritjet e ulëta, të pabarabarta ose më të ulëta se ato që priten nuk e përjashtojnë ekzistencën e një potenciali të lartë. Në këtë Koncept, nënarritja nënkupton mospërputhjen ndërmjet potencialit të nxënësit/nxënëses dhe arritjeve të tij/saj faktike. Nënarritja mund të jetë pasojë e mungesës së sfidave të përshtatshme, nevojave të panjohura, motivimit të ulët, kushteve të pafavorshme ose faktorëve të tjerë personalë dhe të mjedisit.

Treguesit shërbejnë si bazë për vëzhgimin sistematik, krijimin e mundësive të ndryshme për shfaqjen dhe zhvillimin e potencialit, si dhe mbledhjen e informacioneve shtesë. Ata nuk përbëjnë listë përfundimtare kontrolli, kriter të pavarur ose bazë për përcaktimin dhe kategorizimin automatik të nxënësit/nxënëses.

---

[10] Subotnik, R. F., Olszewski-Kubilius, P., & Worrell, F. C. (2011). Rethinking giftedness and gifted education: A proposed direction forward based on psychological science. *Psychological Science in the Public Interest*, *12*(1), 3–54. https://doi.org/10.1177/1529100611418056

II.5. Profile të ndryshme të nxënësve të talentuar dhe të dhuntishëm

Nxënësit e talentuar dhe të dhuntishëm nuk përbëjnë grup homogjen. Ata dallojnë për nga fusha dhe shkalla e shfaqjes së aftësive, mënyra dhe ritmi i të nxënit, motivimi, kreativiteti, karakteristikat personale dhe socio-emocionale, arritjet, përvojat jetësore dhe mbështetja që marrin.

Te disa nxënës, potenciali i lartë është lehtësisht i dukshëm përmes arritjeve vazhdimisht të larta. Ai mund të shfaqet edhe përmes ideve jostandarde, interesave intensive ose aftësive që nuk përfshihen plotësisht në mësimin e rregullt. Disa nxënës e fshehin potencialin për t'u pranuar nga shokët e klasës, ndërsa te të tjerët mungesa e sfidave të përshtatshme, kushtet e pafavorshme, dallimet gjuhësore dhe kulturore ose nevojat e panjohura mund të çojnë në nënarritje dhe ulje të motivimit.

Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet nxënësve te të cilët potenciali i lartë ose aftësitë e zhvilluara bashkëshfaqen me aftësi të kufizuara, vështirësi specifike në të nxënë, çrregullim të vëmendjes ose vështirësi të tjera zhvillimore që kërkojnë mbështetje shtesë arsimore, përfshirë edhe rastet kur këto vështirësi ende nuk janë identifikuar. Për këtë bashkëshfaqje përdoret nocioni **"veçori të dyfishta"**. Te këta nxënës, pikat e forta dhe vështirësitë mund të maskojnë njëra-tjetrën, si pasojë e së cilës potenciali mund të mbetet i paidentifikuar, ndërsa mbështetja mund të përqendrohet vetëm te vështirësitë ose vetëm te aftësitë e larta. [11]

Dyfish i veçantë trajtohet veçmas nga nënarritja dhe nga barrierat sociale, gjuhësore ose mjedisore, ndonëse këto mund të shfaqen njëkohësisht. Vlerësimi duhet të marrë parasysh si pikat e forta, ashtu edhe nevojat për mbështetje shtesë, pa e përjashtuar nevojën për ndihmë për shkak të aftësive të larta dhe pa lejuar që vështirësitë ta mbulojnë potencialin.

[11] Betts, G. T., & Neihart, M. (1988). Profiles of the gifted and talented. *Gifted Child Quarterly, 32*(2), 248–253. https://doi.org/10.1177/001698628803200202 Neihart, M., & Betts, G. T. (2010). *Revised profiles of the gifted and talented* [Matrica e rishikuar e profileve].

III. VLERAT DHE PARIMET

Koncepti mbështetet në respektimin e dinjitetit, të drejtave dhe interesit më të mirë të çdo nxënësi. Vlera e nxënësit nuk varet nga aftësitë, arritjet, prejardhja sociale ose shkalla e zhvillimit të potencialeve të tij. Sistemi arsimor krijon kushte që aftësitë dhe potencialet e ndryshme të njihen, të zhvillohen dhe të mbështeten në kohë, duke siguruar pjesëmarrjen e nxënësit/nxënëses në çështjet që e prekin, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tij.[12]

Mbi këtë bazë, njohja, identifikimi dhe puna edukativo-arsimore me nxënësit/nxënëset e talentuar dhe të dhuntishëm mbështeten në vlerat dhe parimet e mëposhtme, të ndërlidhura ndërmjet tyre.

1. Dinjiteti, mundësitë e barabarta dhe drejtësia

Çdo nxënës/nxënëse ka të drejtë për arsim cilësor dhe mundësi për zhvillimin e potencialeve të veta. Mundësitë e barabarta nënkuptojnë qasje jodiskriminuese në procesin e njohjes, identifikimit dhe mbështetjes, si dhe zvogëlimin e ndikimit të rrethanave ekonomike, sociale, kulturore, gjuhësore, familjare, gjeografike dhe rrethanave të tjera në zhvillimin arsimor.

Drejtësia nuk nënkupton trajtim të njëjtë arsimor, por sigurimin e mbështetjes së përshtatshme me aftësitë, interesat, nevojat dhe karakteristikat zhvillimore të nxënësit/nxënëses. Mbështetja themelore shkollore sigurohet pa pagesë për familjen dhe nuk duhet të varet nga mundësia e saj për të siguruar vlerësim privat, mentorim, pajisje ose shërbime të tjera të jashtme.

2. Gjithëpërfshirja, shumëllojshmëria dhe ndjeshmëria kulturore

Gjithëpërfshirja nënkupton respektimin e shumëllojshmërisë së aftësive, interesave, profileve zhvillimore, ritmeve dhe mënyrave të të nxënit, duke siguruar pjesëmarrje aktive dhe ndjenjën e përkatësisë në bashkësinë shkollore. Mbështetja sigurohet pa krijuar hierarki statusore, etiketim, stigmatizim ose izolim social.

Ndjeshmëria kulturore dhe gjuhësore kërkon që potenciali të shqyrtohet në kontekstin në të cilin nxënësi rritet, mëson dhe shpreh interesat e veta. Sigurohen mundësi të qasshme dhe të përshtatshme nga aspekti gjuhësor, si dhe mënyra të ndryshme që nxënësi ta shfaqë potencialin e vet. Vëmendje e veçantë u kushtohet nxënësve nga grupet e cenueshme dhe të margjinalizuara sociale, nga mjediset rurale dhe të izoluara gjeografikisht, nxënësve me potencial të fshehur ose me nënarritje, si dhe nxënësve me dyfishin e veçantisë.

3. Zhvillimi dhe shumëllojshmëria e qasjeve

Qasja zhvillimore dhe shumëkriteriale nënkupton shqyrtimin e vazhdueshëm të potencialit përmes burimeve të ndryshme, mënyrave të ndryshme të shfaqjes dhe vlerësimeve profesionale, në përputhje me moshën, fushën dhe rrethanat e nxënësit. Mundësitë për të nxënë dhe mbështetja përshtaten në bazë të njohurive të fituara për zhvillimin e tij.

Identifikimi nuk është qëllim në vetvete dhe nuk çon në kategorizimin e përhershëm të nxënësit/nxënëses. Funksioni i tij është të ndihmojë në kuptimin e profilit individual dhe në sigurimin e mbështetjes së përshtatshme edukativo-arsimore.

[12] Organizata e Kombeve të Bashkuara. (1989). *Konventa për të Drejtat e Fëmijës.* Veçanërisht nenet 2, 3, 12 dhe 29.

4. Mirëqenia dhe zhvillimi i gjithanshëm i personalitetit

Zhvillimi i potencialeve të larta lidhet me zhvillimin e gjithanshëm të personalitetit në dimensionin intelektual, emocional, social, moral, krijues dhe fizik. Dhuntia nuk krijon detyrim për arritje vazhdimisht të larta dhe as nuk e justifikon ushtrimin e presionit joproporcional ndaj nxënësit. Mbështetja

siguron sfida të përshtatshme, mbron mirëqenien dhe merr parasysh motivimin, marrëdhëniet me shokët/shoqet e klasës, ndjenjën e përkatësisë dhe nevojat socio-emocionale.

5. Personalizimi, pjesëmarrja dhe autonomia e nxënësit

Mbështetja bazohet në profilin individual të aftësive, interesave, nevojave dhe mënyrave të të nxënit dhe përshtatet me zhvillimin dhe përparimin e nxënësit. Nxënësi informohet dhe merr pjesë në përcaktimin e drejtimeve të zhvillimit dhe mundësive për të nxënë, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tij. Në këtë mënyrë nxiten autonomia, përgjegjësia dhe aftësia e tij për të marrë vendime të informuara.

6. Partneriteti dhe përgjegjësia e përbashkët

Njohja, zhvillimi i potencialeve dhe sigurimi i mbështetjes bazohen në partneritetin dhe përgjegjësinë e përbashkët ndërmjet nxënësit, familjes, shkollës, institucioneve kompetente dhe bashkësisë më të gjerë, secili brenda kompetencave dhe roleve të veta profesionale. Bashkëpunimi me prindërit, përkatësisht kujdestarët, është i vazhdueshëm dhe i dyanshëm, por qasja në mbështetje nuk varet nga niveli i informimit të tyre, burimet që kanë në dispozicion ose mundësia për ta përfaqësuar fëmijën.

Kur nevojat dhe potencialet e nxënësit e kërkojnë këtë, shkolla vendos bashkëpunim me institucionet, shoqatat dhe profesionistët përkatës. Partneritetet i zgjerojnë mundësitë për të nxënë dhe zhvillim dhe krijohen duke respektuar interesin më të mirë dhe sigurinë e nxënësit.

7. Etika, konfidencialiteti, proporcionaliteti dhe veprimi i përgjegjshëm

Veprimi profesional është transparent, i paanshëm dhe i orientuar drejt interesit më të mirë të nxënësit. Metodat, instrumentet dhe dokumentacioni janë të përshtatshme për moshën, karakteristikat zhvillimore dhe nevojat e nxënësit dhe nuk krijojnë ngarkesë të panevojshme administrative. Privatësia dhe të dhënat personale mbrohen, ndërsa informacionet mblidhen, përdoren dhe ndahen vetëm në masën e nevojshme për qëllimin e përcaktuar dhe në përputhje me dispozitat në fuqi.

Këto vlera dhe parime zbatohen në të gjitha pjesët e Konceptit dhe përbëjnë bazën për hartimin e procedurave, protokolleve, instrumenteve, udhëzimeve profesionale dhe programeve për zhvillimin profesional.

IV. NJOHJA DHE IDENTIFIKIMI I NXËNËSVE TË TALENTUAR DHE TË DHUNTISHËM

IV.1. Qëllimi dhe vendosja konceptuale

Njohja dhe identifikimi i nxënësve të talentuar dhe të dhuntishëm janë pjesë e një procesi të vetëm, të vazhdueshëm dhe zhvillimor, që ka për qëllim themelor njohjen në kohë të potencialeve, interesave, pikave të forta dhe nevojave edukativo-arsimore të nxënësit, si dhe sigurimin e mbështetjes së përshtatshme për zhvillimin e tyre. Procesi nuk synon veçimin, renditjen ose etiketimin e nxënësve, por krijimin e kushteve që secili nxënës të përparojë në përputhje me mundësitë e veta.

Qasja zhvillimore ndaj dhuntisë dhe talentit (Renzulli; Ganje) e ndërlidh njohjen me punën edukativo-arsimore. Nxënësit i ofrohen mundësi të përshtatshme për ta shfaqur dhe zhvilluar potencialin, ndërsa reagimi dhe përparimi i tij shfrytëzohen si burim shtesë i dëshmive gjatë identifikimit.[13]

Sistemi bazohet në procese të ndërlidhura në mënyrë ciklike: **njohja → zhvillimi dhe ndjekja e potencialit → identifikimi → planifikimi dhe zbatimi i mbështetjes → ndjekja apo monitorimi dhe rivlerësimi.** Fazat nuk zhvillohen gjithmonë në mënyrë strikte njëra pas tjetrës. Në varësi të moshës, fushës së potencialit dhe nevojave të nxënësit, një fazë e caktuar mund të zgjasë më shumë, të përsëritet ose të zhvillohet paralelisht me një fazë tjetër.


Njohja fillon gjatë mësimit të rregullt dhe në aktivitetet e tjera shkollore dhe jashtëshkollore. Identifikimi profesional i ndërlidh njohuritë pedagogjike të mbledhura me vlerësimet shtesë të nevojshme për përcaktimin e profilit individual të aftësive, potencialeve dhe nevojave arsimore.

[13] Renzulli, J. S. (2005). The three-ring conception of giftedness: A developmental model for promoting creative productivity. In R. J. Sternberg & J. E. Davidson (Eds.), *Conceptions of giftedness* (2nd ed., pp. 246–279).
Cambridge University Press. Gagné, F. (2004). Transforming gifts into talents: The DMGT as a developmental theory. *High Ability Studies*, *15*(2), 119–147.

https://doi.org/10.1080/1359813042000314682

Paraqitja grafike 1. Cikli zhvillimor i njohjes, identifikimit dhe mbështetjes

Grafiku 1. Cikli zhvillimor i njohjes, identifikimit dhe mbështetjes



Mbështetja fillon që në fazën e njohjes.

Identifikimi formal nuk është kusht për ofrimin e mbështetjes bazë në shkollë.

IV.2. Parimet e njohjes dhe identifikimit

Të mbështetura në vlerat dhe parimet e përgjithshme të Konceptit, proceset e njohjes dhe identifikimit kanë këto karakteristika të veçanta:

- **zhvillim dhe vazhdimësi** – potenciali përcillet gjatë një periudhe më të gjatë kohore dhe në situata të ndryshme, ndërsa vlerësimi rishqyrtohet në përputhje me zhvillimin dhe efektet e mbështetjes;

- **qasje shumëkriteriale dhe me burime të shumta** – kombinohen të dhënat nga vëzhgimi sistematik, punimet dhe portofoli i nxënësit, arritjet, bisedat, vlerësimet dhe, kur është e nevojshme, instrumentet e standardizuara;
- **multidisiplinaritet dhe përgjegjësi e përbashkët profesionale** – në proces marrin pjesë mësimdhënësit, bashkëpunëtorët profesionalë dhe profesionistë të tjerë përkatës, secili brenda kompetencave të veta;
- **drejtësi dhe ndjeshmëri kulturore** – zbatohen procedura që e zvogëlojnë ndikimin e dallimeve gjuhësore, sociale dhe kulturore, si dhe të paragjykimeve që lidhen me gjininë dhe bazat e tjera përkatëse;
- **pjesëmarrja e nxënësit dhe partneriteti me prindërit/kujdestarët** – nxënësi, në përputhje me moshën dhe pjekurinë, merr pjesë në shqyrtimin e interesave, qëllimeve dhe nevojave të veta, ndërsa prindërit/kujdestarët informohen dhe përfshihen me kohë;
- **profesionalizëm, etikë dhe konfidencialitet** – instrumentet dhe protokollet zbatohen nga persona me kualifikimet përkatëse, ndërsa të dhënat mblidhen vetëm në masën e nevojshme për marrjen e vendimeve edukativo-arsimore dhe planifikimin e mbështetjes, si dhe ruhen e përdoren në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale;
- **ekonomicitet dhe funksionalitet** – procedurat përfshihen në punën e rregullt të shkollës dhe nuk krijojnë ngarkesë të panevojshme administrative.

Njohja dhe identifikimi duhet të jenë mjaftueshëm gjithëpërfshirëse për t'i përfshirë edhe nxënësit, potenciali i të cilëve nuk shfaqet përmes notave të larta ose arritjeve të zakonshme shkollore. Drejtësia nuk nënkupton zbatimin e së njëjtës procedurë për të gjithë, por krijimin e mundësive që secili nxënës ta shfaqë potencialin në mënyrë të përshtatshme me karakteristikat dhe rrethanat e veta.

IV.3. Fazat, procedurat, burimet dhe bartësit e procesit

Faza e parë: Njohja e treguesve të potencialit të lartë

Njohja zbatohet në mënyrë të vazhdueshme, kryesisht gjatë mësimit të rregullt. Mësimdhënësi vëzhgon në mënyrë sistematike mënyrën se si nxënësi mëson, parashtron pyetje, zgjidh detyra, krijon produkte origjinale, ndërlidh njohuritë, shfaq interes dhe këmbëngulje, si dhe reagon ndaj detyrave komplekse dhe sfiduese. Përcillen gjithashtu shpejtësia dhe thellësia e të nxënit, nevoja për sfida më të mëdha, kreativiteti, pavarësia dhe aftësitë specifike në fusha të veçanta.

Vëzhgimi përfshin të gjithë nxënësit/nxënëset që nga fillimi i arsimit fillor. Në mësimin në klasë, veçanërisht i rëndësishëm është njohja e vazhdueshme e nxënësit/nxënëses dhe ndërlidhja e njohurive nga fusha të ndryshme. Metodat dhe dëshmitë përshtaten me periudhën zhvillimore; mosha, në vetvete, nuk përbën arsye për shtyrjen e vlerësimit të nevojshëm profesional.

Për të zvogëluar subjektivitetin, mësimdhënësi/mësimdhënësja përdor kategori të përcaktuara paraprakisht për vëzhgim dhe mbledh dëshmi të ndryshme: shënime nga vëzhgimi sistematik, lista të treguesve dhe shkallë vlerësimi që plotësohen nga mësimdhënësi/mësimdhënësja, shembuj të punimeve të nxënësit/nxënëses, portofol, produkte të projekteve dhe hulumtimeve, rezultate nga detyrat komplekse dhe të hapura, të dhëna për interesat dhe motivimin, si dhe arritje përkatëse. Në vlerësim mund të përfshihen informacione nga nxënësi/nxënësja, prindërit/kujdestarët, mësimdhënësit/mësimdhënëset e tjerë/a, shokët/shoqet e klasës dhe profesionistët ose mentorët jashtë shkollës. Çdo informacion shqyrtohet në kontekst dhe nuk përdoret si bazë e vetme për identifikim.

Nominimi përfaqëson nismën e arsyetuar për shqyrtimin e potencialit dhe nevojave arsimore të nxënësit/nxënëses. Nismën mund ta paraqesë një

mësimdhënës/mësimdhënëse, bashkëpunëtor profesional, prind/kujdestar, vetë nxënësi/nxënësja përmes vetënomimit ose një person tjetër përkatës. Ajo mbështetet me shembuj dhe njohuri të disponueshme, por nuk përbën konfirmim të identifikimit. Ekipi shkollor për nxënësit/nxënëset e talentuar dhe të dhuntishëm (në vijim: ekipi shkollor) i shqyrton informacionet dhe përcakton se cilat mundësi shtesë për të nxënë, burime të dëshmive dhe forma të përcjelljes janë të nevojshme.

Protokolli kombëtar përcakton më hollësisht mënyrat e paraqitjes së nismës, konfirmimin e pranimit, personin përgjegjës, afatin e shqyrtimit dhe informimin kthyes të arsyetuar. Formularët duhet të jenë të shkurtër dhe të kuptueshëm për nxënësit/nxënëset dhe prindërit/kujdestarët. Mundësia e nominimit nuk e zëvendëson detyrimin për vëzhgimin proaktiv të të gjithë nxënësve/nxënëseve gjatë mësimit.

Faza e dytë: Zhvillimi dhe përcjellja e potencialit

Nxënësit i sigurohen mundësi të pasuruara, të thelluara dhe sfiduese për të nxënë, në kuadër të mësimit të rregullt dhe aktiviteteve të tjera shkollore. Ato mund të përfshijnë detyra të diferencuara dhe të hapura, punë me projekte dhe hulumtime, ritëm fleksibil të të nxënit, burime shtesë, zgjidhjen e detyrave që lidhen me situata reale, pjesëmarrjen në klube dhe seksione, si dhe bashkëpunimin me mentor.

Qëllimi i kësaj faze është që njëkohësisht të zhvillohet potenciali dhe të mblidhen dëshmi më të besueshme për mënyrën se si nxënësi reagon ndaj sfidave më të mëdha. Masat fillestare planifikohen në bazë të vlerësimeve pedagogjike për pikat e forta, interesat dhe nevojat, të cilat plotësohen gjatë procesit të përcjelljes. Në varësi të fushës dhe qëllimeve zhvillimore, përcillen përparimi, cilësia dhe ndërlikueshmëria e punës, pavarësia, këmbëngulja, kreativiteti, motivimi dhe nevoja për përshtatje. Këto njohuri përfshihen në profilin individual gjatë identifikimit profesional. Në këtë mënyrë, vlerësimi mbështetet edhe në zhvillimin e dëshmuar në kushte të përshtatshme, e jo vetëm në mundësitë dhe arritjet e mëparshme të nxënësit (Subotnik, Olszewski-Kubilius dhe Worrell).[14]

Mësimdhënësi e dokumenton përparimin, ndërsa ekipi shkollor i shqyrton periodikisht dëshmitë së bashku me nxënësin dhe prindërit/kujdestarët. Në bazë të udhëzimeve nga protokolli kombëtar, ekipi arsyeton se cilat çështje kërkojnë identifikim profesional ose cilat dëshmi shtesë duhet të mblidhen përmes zhvillimit dhe përcjelljes së potencialit. Kur mbledhja e dëshmive vazhdon, përcaktohen qëllimi, personi përgjegjës dhe afati për rishqyrtim. Pavarësisht nga rezultati, nxënësi/nxënësja merr mbështetjen e përshtatshme edukativo-arsimore, ndërsa përcjellja e rregullt e zhvillimit të tij/saj vazhdon.

Faza e tretë: Identifikimi profesional

Identifikimi është përcaktimi profesional i profilit individual të aftësive, potencialeve, interesave, arritjeve dhe nevojave edukativo-arsimore. Ai iniciohet kur njohuritë e disponueshme tregojnë nevojën për një vlerësim më të plotë profesional, me qëllim orientimin e mbështetjes, përfshirë rastet e gjetjeve të papërputhshme, të potencialit të fshehur ose të nevojave më komplekse arsimore. Në arsyetim përcaktohen fusha, çështjet që duhet të sqarohen përmes vlerësimit dhe dëshmitë e disponueshme. Protokolli kombëtar e shtjellon procedurën dhe afatet, pa e zgjatur pa arsye periudhën e vëzhgimit paraprak.

[14] Subotnik, R. F., Olszewski-Kubilius, P., & Worrell, F. C. (2011). Rethinking giftedness and gifted education: A proposed direction forward based on psychological science. *Psychological Science in the Public Interest, 12*(1), 3–54. https://doi.org/10.1177/1529100611418056

Përzgjedhja dhe vëllimi i vlerësimit përcaktohen në bazë të çështjeve të parashtruara, moshës, fushës dhe nevojave të nxënësit/nxënëses; nuk është e detyrueshme

që të gjitha instrumentet të zbatohen te çdo nxënës/nxënëse. Mund të përdoren kategoritë e mëposhtme të instrumenteve dhe burimeve:

- instrumente të standardizuara për vlerësimin e aftësive të përgjithshme dhe specifike intelektuale;
- instrumente dhe procedura për vlerësimin e kreativitetit;
- teste të standardizuara të njohurive dhe arritjeve në fushën përkatëse, kur janë të disponueshme dhe të përshtatshme për qëllimin e vlerësimit;
- instrumente për shqyrtimin e motivimit, interesave, këmbënguljes dhe karakteristikave përkatëse personale dhe socio-emocionale;
- shkallë vlerësimi që plotësohen nga mësimdhënësi/mësimdhënësja, vëzhgime të strukturuara dhe intervista;
- portofol, punime të nxënësit/nxënëses, performanca dhe arritje;
- detyra dhe vlerësime të përshtatshme për fushën specifike të talentit;
- bisedë me nxënësin/nxënësen dhe prindërit/kujdestarët, si dhe analizë e dokumentacionit përkatës pedagogjik.

Përcjellja pedagogjike dhe vlerësimi psikologjik janë procedura të ndryshme, por plotësuese profesionale. Mësimdhënësi/mësimdhënësja dhe pedagogu/pedagogia sigurojnë njohuri për të nxënit, sjelljen, interesat dhe zhvillimin e potencialit në kontekstin edukativo-arsimor, ndërsa psikologu/psikologia është përgjegjës/e për zbatimin dhe interpretimin e instrumenteve psikologjike. Instrumentet e standardizuara psikologjike zbatohen dhe interpretohen nga psikologu/psikologia i/e kualifikuar dhe i/e autorizuar, duke siguruar informimin dhe pëlqimin kur kjo kërkohet me ligj. Instrumentet që përdoren për krahasim normativ dhe për marrjen e vendimeve profesionale lidhur me identifikimin duhet të kenë validitet dhe besueshmëri (reliabilitet) të përshtatshme, norma, si dhe zbatueshmëri kulturore dhe gjuhësore. Nëse përdoren burime të tjera ose materiale të përshtatura, vlera e tyre informuese interpretohet në mënyrë të kufizuar dhe ato nuk përdoren kurrë si bazë e vetme për marrjen e vendimit.[15]

Njohuritë pedagogjike, gjetjet psikologjike dhe vlerësimet në fushën specifike shqyrtohen së bashku, duke i ndarë detyrat profesionale në përputhje me kapitullin VI.1. Në rast të vështirësive të njëkohshme, përfshihet edhe edukatori special dhe rehabilituesi ose bashkëpunëtori profesional kompetent. Kur nevojitet kapacitet profesional që nuk është në dispozicion, ekspertizë shtesë ose vlerësim i pavarur, shkolla organizon bashkëpunim të jashtëm sipas procedurës së përcaktuar në kapitullin VI. Familjes nuk i kushtëzohet sigurimi i vlerësimit privat.

Ekipi shkollor i bashkon gjetjet përkatëse në një propozim të integruar profesional, i cili përmban profilin individual të arsyetuar, fushat e potencialit, nevojat zhvillimore dhe arsimore, si dhe rekomandimet për punën edukativo-arsimore. Në propozim theksohet mënyra se si njohuritë e fituara orientojnë ndërlikueshmërinë e detyrave, ritmin, mënyrën e të nxënit dhe përshtatjet e nevojshme. Respektohen kufizimet e gjetjeve dhe përgjegjësia profesionale e secilit profil të përfshirë. Kur gjetjet janë të ndryshme ose nuk përputhen mjaftueshëm, përcaktohet se çfarë duhet të sqarohet më tej përmes të dhënave të reja, përcjelljes ose marrjes së një mendimi të dytë profesional.

[15] Pfeiffer, S. I. (2015). *Essentials of gifted assessment*. Wiley. https://doi.org/10.1002/9781394259410

Faza e katërt: planifikimi, mbështetja dhe rivlerësimi

Në bazë të profilit individual, shkolla, në bashkëpunim me nxënësin dhe prindërit/kujdestarët, harmonizon qëllimet zhvillimore, masat, personat përgjegjës dhe mënyrën e përcjelljes. Mësimdhënësi i përfshin rekomandimet në planifikimin mësimor dhe përcjell zbatimin e tyre. Kur nevojitet punë e koordinuar afatgjatë ose më komplekse, hartohet plan individual për mbështetje edukativo-arsimore, në përputhje me kapitullin V.5.

Identifikimi nuk është kusht që nxënësi/nxënësja të marrë mbështetje fillestare të pasuruar dhe as pikë përfundimtare e procesit. Nëse përcjellja tregon se mbështetja e zbatuar nuk paraqet sfidë të përshtatshme ose nuk u përgjigjet nevojave, plani ndryshohet, mblidhen dëshmi të reja dhe, sipas nevojës, bëhet rivlerësimi.

Ekipi shkollor dhe ndarja e përgjegjësive

Ekipi shkollor koordinon ndërlidhjen ndërmjet njohjes, zhvillimit të potencialit, identifikimit profesional dhe mbështetjes. Organizimi, përbërja dhe përgjegjësitë e tij përcaktohen në kapitullin VI.1. Shqyrtimi në ekip nuk e zëvendëson përgjegjësinë e secilit profil profesional për vlerësimin që realizon.

IV.4. Nxënësit te të cilët potenciali identifikohet më vështirë

Vëmendje e veçantë u kushtohet nxënësve te të cilët potenciali i lartë është i fshehur, i zhvilluar në mënyrë të pabarabartë ose nuk shprehet përmes arritjeve të zakonshme shkollore. Në këtë grup mund të bëjnë pjesë:

- nxënësit me potencial jashtëzakonisht të lartë dhe zhvillim të pabaraspeshuar kognitiv, emocional dhe social;
- nxënësit me potencial të lartë dhe vështirësi të njëkohshme në të nxënë, aftësi të kufizuara ose nevoja të tjera arsimore, përkatësisht nxënësit me dyfishin e veçantisë;
- nxënësit/nxënëset, arritjet e të cilëve/të cilave janë më të ulëta se mundësitë e tyre për shkak të mungesës së sfidave të mjaftueshme, motivimit të ulët, përvojave të pafavorshme, ankthit ose faktorëve të tjerë personalë dhe mjedisorë;
- nxënësit/nxënëset nga mjedise me kushte të pafavorshme sociale dhe ekonomike, nga mjedise rurale, nga bashkësi të ndryshme gjuhësore dhe kulturore ose nxënësit/nxënëset me mundësi të kufizuara për qasje në përmbajtje shtesë arsimore;
- nxënësit/nxënëset, potenciali i të cilëve/të cilave shfaqet në fusha specifike, jashtë formave të zakonshme të vlerësimit shkollor.

Për këta nxënës sigurohen mënyra të shumëllojshme për shfaqjen e potencialit, përshtatje gjuhësore dhe të qasjes, si dhe mundësi reale për të nxënë. Kohëzgjatja e vëzhgimit përcaktohet në bazë të nevojave dhe dëshmive të disponueshme, pa e shtyrë automatikisht vlerësimin profesional për shkak të përkatësisë së grupit të caktuar. Përshtatjet dokumentohen dhe merret parasysh ndikimi i tyre në interpretimin e rezultateve dhe në validitetin e vlerësimit.

Kur ekziston dyshimi për dyfishin e veçantisë, vlerësimi merr parasysh zhvillimin e pabarabartë të aftësive, dallimet ndërmjet mënyrave të shfaqjes së tyre dhe ndikimin e vështirësive në arritjet. Ndërthuren njohuritë e siguruara nga nxënësi/nxënësja, familja, mësimdhënësit dhe profesionistët përkatës, punimet e nxënësit, si dhe përcjellja e të nxënit me mbështetje. Rezultati i përgjithshëm i testit interpretohet në kontekstin e profilit dhe të kufizimeve të instrumentit. Diagnoza e mëparshme, notat e larta, sjellja e përkryer ose arritjet njësoj të larta në të gjitha fushat nuk janë parakushte për shqyrtimin e potencialit.

Kur ekziston dyshim i bazuar se vështirësia ose kushtet e vlerësimit e kanë fshehur potencialin, përcaktohen plotësimet e nevojshme të dëshmive dhe afati për rishqyrtim, me pjesëmarrjen e nxënësit dhe prindërve/kujdestarëve. Udhëzimet e veçanta në kuadër të protokollit kombëtar i shtjellojnë procedurat e qasjes, përshtatjet dhe ndikimin e tyre në validitetin e vlerësimit, integrimin e gjetjeve dhe referimin (Shtojca 1, dokumenti 10). Mbështetja mësimore dhe harmonizimi i planeve rregullohen në kapitujt V.2 dhe V.5, ndërsa koordinimi i ekipeve të përfshira në kapitullin VI.1.

IV.5. Rezultatet, dokumentacioni, mekanizmat mbrojtës dhe parakushtet sistemore

Rezultati është profil individual i dokumentuar dhe një rekomandim për mbështetje. Nxënësi/nxënësja, në përputhje me moshën dhe pjekurinë, si dhe prindërit/kujdestarët, informohen për rrjedhën e procedurës, gjetjet dhe rekomandimet, mund të japin mendimin e tyre dhe kanë qasje në përputhje me dispozitat në fuqi. Personave të tjerë të përfshirë u komunikohen vetëm informacionet e nevojshme për mbështetjen.

Shkolla dokumenton rrjedhën e procedurës, burimet e përdorura, propozimin e integruar profesional, mbështetjen e dakorduar dhe përparimin. Këto të dhëna ndërlidhen me evidencën ekzistuese pedagogjike dhe portofolin zhvillimor, sipas përcaktimeve në kapitullin VI.3. Vazhdimësia e informacioneve përkatëse dhe e mbështetjes gjatë kalimeve sigurohet në përputhje me kapitullin VII dhe dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Mekanizmat mbrojtës përfshijnë informimin; pëlqimin për testimin e specializuar dhe shkëmbimin e të dhënave, kur kjo kërkohet me ligj; pjesëmarrjen e nxënësit/nxënëses; marrjen e një mendimi të dytë profesional, paraqitjen e ankesës ose rishqyrtimin; qasjen e kufizuar në të dhëna; ndalimin e diskriminimit dhe etiketimit; shqyrtimin periodik të përfundimeve dhe verifikimin e drejtësisë. Mospajtimi i prindit/kujdestarit ose refuzimi i nxënësit evidentohen dhe shqyrtohen duke respektuar të drejtat dhe interesin më të mirë të tij, pa ndërprerë automatikisht mbështetjen bazë shkollore.

Pas miratimit të Konceptit, përgatitet protokolli kombëtar për njohjen dhe identifikimin, së bashku me instrumentet, udhëzimet dhe formularët shoqërues. Ai i shtjellon mënyrat e inicimit të procedurës, burimet e nevojshme të dëshmive, afatet, përfundimin profesional dhe nënshkrimin e tij, rishqyrtimin, si dhe veprimet në rast të gjetjeve të ndryshme, mospajtimit ose mungesës së kapaciteteve profesionale. Çështjet që kërkojnë rregullim ligjor përcaktohen me aktin përkatës.

Pasqyra e unifikuar në Shtojcën 1 përcakton dokumentet e nevojshme dhe ndërlidhjen e tyre me kapitujt përkatës. Për këtë fushë veçanërisht të rëndësishme janë dokumentet 2–10, 12, 17–19 dhe 22: protokolli, instrumentet për vëzhgim dhe nominim, kriteret dhe instrumentet, profili individual, mendimi i dytë profesional, udhëzimet për dyfishin e veçantisë, planifikimi, dokumentacioni dhe përcjellja.

Byroja e Zhvillimit të Arsimit, në kuadër të kompetencave të veta dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet shkencore, si dhe shoqatat përkatëse profesionale, siguron bazën profesionale për zhvillimin dhe avancimin e këtyre dokumenteve. Mënyra e organizimit të vlerësimit të jashtëm profesional, kriteret për autorizim dhe sistemi i sigurimit të cilësisë rregullohen më tej me aktet përkatëse.

Për të siguruar profesionalizëm, qasje të barabartë dhe krahasueshmëri të procedurave, krijohet një kapacitet profesional kombëtar për mbështetje psikologjike dhe psikometrike të identifikimit. Ky funksion mund të organizohet në kuadër të një institucioni të autorizuar të arsimit të lartë ose shkencor, një instituti profesional apo një subjekti tjetër të përcaktuar me ligj. Ai përfshin përzgjedhjen dhe vlerësimin profesional të instrumenteve, sigurimin e licencave, përkthimin dhe përshtatjen kulturore e gjuhësore, pilotimin dhe standardizimin kombëtar, hartimin e normave dhe manualeve, trajnimin dhe mbikëqyrjen profesionale të psikologëve, ruajtjen e sigurt dhe shpërndarjen e kontrolluar të instrumenteve, dhënien e mendimit të dytë profesional dhe verifikimin periodik të validitetit, drejtësisë dhe paragjykimeve të mundshme. Para krijimit të këtij kapaciteti, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në bashkëpunim me Byronë, institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet shkencore, si dhe shoqatat profesionale, përgatit një analizë të fizibilitetit dhe një propozim-model për organizimin, financimin dhe sigurimin e cilësisë.

Zhvillimi dhe standardizimi i instrumenteve janë funksion sistemor. Vlerësimi i një nxënësi të caktuar organizohet sipas nevojës së përcaktuar dhe kapaciteteve profesionale, përmes bashkëpunëtorëve profesionalë të shkollës dhe bashkëpunimit të jashtëm kur është e nevojshme. Krijimi i kapacitetit kombëtar nuk nënkupton referimin e detyrueshëm të çdo nxënësi/nxënëseje në një procedurë të centralizuar.

V. MASAT DHE AKTIVITETET PËR PUNËN EDUKATIVO-ARSIMORE ME NXËNËSIT E TALENTUAR DHE TË DHUNTISHËM

V.1. Qëllimi dhe vendosja e masave dhe aktiviteteve

Masat dhe aktivitetet për punën edukativo-arsimore, të parashikuara me Ligjin për Arsimin Fillor, synojnë zhvillimin e potencialeve, interesave, kreativitetit dhe mirëqenies së nxënësit. Ato ndërlidhin njohuritë e fituara gjatë njohjes dhe identifikimit me planifikimin dhe realizimin e mbështetjes përkatëse.[16]

Masat dhe aktivitetet përcaktohen në bazë të njohurive pedagogjike të disponueshme dhe profilit individual, nëse është hartuar, fushën dhe shkallën e zhvillimit të potencialit, interesave, mënyrës dhe ritmit të të nxënit, si dhe nevojave socio-emocionale. Merren parasysh kompetencat tashmë të zhvilluara dhe mundësitë e mëparshme për të nxënë, në mënyrë që mbështetja t'u përshtatet si nxënësve me arritje të dukshme, ashtu edhe atyre me potencial ende të pazhvilluar mjaftueshëm. Format përzgjidhen dhe kombinohen në përputhje me qëllimet zhvillimore, përparimin dhe reagimin e nxënësit.

Mësimi i rregullt është baza e vazhdueshme e mbështetjes, në mjedisin natyror të gjithëpërfshirjes së klasës. Sipas nevojave të nxënësit/nxënëses, që nga fillimi ai mund të kombinohet me programe shkollore, projekte, mentorim dhe mundësi të jashtme profesionale dhe të specializuara. Përfshirja e tyre nuk kërkon shterimin paraprak të të gjitha formave të punës në kuadër të mësimit të rregullt. Përparimi i përshpejtuar shqyrtohet si mundësi e veçantë kur është i arsyetuar profesionalisht dhe i mundësuar nga aktet normative.


Format e ndërlidhura të mbështetjes përshtaten në bazë të përcjelljes së vazhdueshme të nxënësit dhe të efekteve të masave të zbatuara.[17]

[16] Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2019). *Ligji për Arsimin Fillor.* "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 161/2019, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Neni 34.

[17] Zavod Republike Slovenije za šolstvo. (2025). *Koncept prepoznavanja nadarjenih otrok, učencev in dijakov ter vzgojno-izobraževalnega dela z njimi* [Burim nga një botim online slloven i vitit 2025]. Ministarstvo znanosti i obrazovanja Republike Hrvatske. (2022). *Smjernice za rad s darovitom djecom i učenicima*. Министарство просвете Републике Србије. (2023). *Стручно упутство за препознавање, подршку и праћење образовања и васпитања ученика/ца са изузетним/посебним способностима*.

Paraqitja grafike 2. Format e ndërlidhura të mbështetjes edukativo-arsimore

Grafiku 2. Format e ndërlidhura të mbështetjes edukativo-arsimore



V.2. Masat në kuadër të mësimit të rregullt

Mësimi i rregullt është vendi kryesor për punën me nxënësit/nxënëset e talentuar dhe të dhuntishëm. Mësimdhënësi/mësimdhënësja e përshtat mësimin në përputhje me njohuritë paraprake, interesat dhe mundësitë e nxënësit/nxënëses, pa e veçuar atë në mënyrë të përhershme nga grupi i shokëve/shoqeve të klasës dhe pa e kufizuar mbështetjen në dhënien e një numri më të madh detyrash të njëjta.

Në mësimin klasor, njohja e vazhdueshme e nxënësit/nxënëses mundëson njohjen e hershme të potencialit dhe planifikimin e harmonizuar të mbështetjes. Kur përfshihen më shumë mësimdhënës/mësimdhënëse dhe gjatë kalimit në mësimin lëndor, bashkëpunimi i tyre siguron shkëmbimin e njohurive përkatëse pedagogjike dhe vazhdimësinë e përshtatjeve.

Masat në mësimin e rregullt përfshijnë:

- diferencimin dhe individualizimin e përmbajtjeve, detyrave, metodave, ritmit dhe produkteve të pritshme;

- pasurimin dhe thellimin e të nxënit përmes përmbajtjeve më të gjera dhe më komplekse, ndërlidhjes ndërmjet lëndëve dhe zbatimit të njohurive në situata të reja;
- detyra të nivelit më të lartë kognitiv, detyra të hapura, hulumtim, argumentim, eksperimentim dhe shprehje krijuese;
- ritëm fleksibil, zvogëlimin e përsëritjes së panevojshme të përmbajtjeve të përvetësuara tashmë dhe orientimin e kohës së liruar drejt pasurimit, thellimit dhe detyrave më komplekse;
- mundësinë e zgjedhjes së temës, mënyrës së punës, burimit, produktit ose mënyrës së prezantimit;
- punë të pavarur, me projekte, të bazuar në detyra dhe hulumtuese;
- grupim fleksibil të herëpashershëm të nxënësve me interesa ose nevoja të përafërta dhe të nxënë bashkëpunues, me sfida të përshtatshme për secilin nxënës;
- informacion kthyes formativ, vetëvlerësim dhe pjesëmarrje të nxënësit/nxënëses në përcaktimin e qëllimeve.

Pasurimi paraqet zgjerim cilësor të mundësive për të nxënë, ndërsa thellimi mundëson kuptim më kompleks, ndërlidhje dhe zbatim të pavarur në fushën e interesit. Mësimdhënësi i përfshin përshtatjet në planifikimin e rregullt, duke ndërlidhur njohuritë fillestare për nxënësin me qëllimet zhvillimore, përmbajtjet mësimore, metodat, ritmin dhe rezultatet e pritshme. Paraprakisht përcakton se përmes cilave dëshmi do ta vlerësojë përparimin dhe kur do ta rishqyrtojë masën. Përmes aktiveve profesionale dhe me mbështetjen e pedagogut, përshtatjet harmonizohen ndërmjet lëndëve dhe gjatë periudhave të ndryshme arsimore, duke krijuar mundësi për ndërlidhje ndërmjet lëndëve. Sfida e përzgjedhur duhet ta nxisë zhvillimin pa shkaktuar mbingarkesë të panevojshme.

Zvogëlimi i përsëritjes bazohet në verifikimin pedagogjik të përvetësimit të rezultateve të pritshme, në kuadër të qëllimeve dhe standardeve të programit mësimor. Kjo përshtatje e punës në mësimin e rregullt dallohet nga përparimi formal i përshpejtuar, i rregulluar në pjesën V.6.

Mbështetja edukativo-arsimore synon gjithashtu zhvillimin e qëllimshëm dhe të vazhdueshëm të kreativitetit, motivimit të brendshëm, vetërregullimit dhe strategjive metakognitive, gjatë mësimit, aktiviteteve jashtëmësimore dhe punës me mentor. Përmes detyrave të hapura, të nxënit të bazuar në zgjidhjen e detyrave dhe hulumtimit, si dhe mundësive për të zgjedhur, nxënësi/nxënësja nxitet të krijojë zgjidhje origjinale dhe ta zbatojë atë që ka mësuar në situata të reja. Mësimdhënësi/mësimdhënësja e udhëzon në përcaktimin e qëllimeve, planifikimin e punës, përzgjedhjen e strategjive dhe vetëvlerësimin e përparimit. Krijohet një mjedis ku provimi i qasjeve të reja dhe të nxënit nga gabimet pranohen si pjesë e procesit të të nxënit. Vlerësohen përpjekjet dhe përparimi individual, pa u mbështetur së tepërmi në shpërblime ose në krahasimin e vazhdueshëm me nxënësit/nxënëset e tjerë/tjera.

Vlerësimi bazohet në programet mësimore, standardet dhe dispozitat në fuqi. Puna me detyra më komplekse, hulumtimet dhe produktet shfrytëzohen për dhënien e informacionit kthyes formativ dhe përcjelljen e përparimit individual. Nxënësit nuk u parashtrohen kërkesa më të larta, pa arsye, për marrjen e së njëjtës notë vetëm për shkak se shfaqin potencial të lartë; kriteret dhe qëllimi i sfidave shtesë përcaktohen paraprakisht dhe janë të qarta.

Te nxënësit me dyfishin e veçantisë zbatohet diferencimi i dyfishtë: përmbajtje sfiduese për zhvillimin e pikave të forta dhe, njëkohësisht, përshtatje për qasje dhe të nxënë. Sipas nevojave, sigurohen mënyra të ndryshme të shprehjes, udhëzime të strukturuara, mbështetje për organizimin, kohë e përshtatshme dhe teknologji ndihmëse. Përshtatja e ruan sfidën në fushën e potencialit dhe mundëson shfaqjen e njohurive pa ndikimin e panevojshëm të vështirësisë. Zhvillimi i aftësive nuk shtyhet deri në tejkalimin e vështirësive. Shembujt konkretë shtjellohen në udhëzimet në Shtojcën 1, dokumentet 10 dhe 11.

Këto masa mund të fillojnë të zbatohen që në fazën e identifikimit fillestar dhe nuk kushtëzohen nga përfundimi i procesit formal të identifikimit. Mësimdhënësi/mësimdhënësja e përcjell efektin, ruan punime të përzgjedhura të nxënësit/nxënëses dhe mbledh shënime të shkurtra e përkatëse për përparimin. Njohuritë e fituara shfrytëzohen edhe për planifikimin e mëtejshëm të punës dhe, kur është e nevojshme, si pjesë e dëshmive në procedurën e identifikimit.

V.3. Mundësi të zgjeruara brenda dhe jashtë shkollës

Shkolla siguron një përzgjedhje më të gjerë aktivitetesh, përmes të cilave nxënësit mund t'i hulumtojnë interesat, t'i zhvillojnë aftësitë specifike dhe të krijojnë produkte me shkallë më të lartë kompleksiteti. Në përputhje me nevojat e nxënësve/nxënëseve dhe burimet në dispozicion, mund të organizohen mësimi plotësues, klubet dhe seksionet, projektet lëndore dhe ndërmjet lëndëve, grupet hulumtuese, ditët e projekteve, punëtoritë krijuese, debatet, ekspozitat, paraqitjet, manifestimet, konferencat e nxënësve, kampet, shkollat verore dhe prezantimet publike.

Mësimi shtesë planifikohet si formë e mbështetjes së rregulluar me ligj, e cila u ofrohet nxënësve që tregojnë rezultate të konsiderueshme në lëndë të caktuara, në përputhje me nenin 32 të Ligjit për Arsimin Fillor. Mësimdhënësi e organizon dhe e ofron këtë formë të mësimit, ndërsa nxënësi vendos nëse dëshiron të marrë pjesë. Mësimi shtesë ndërlidhet me masat e tjera mbështetëse, në përputhje me nevojat individuale të nxënësit.

Për aktivitetet përcaktohen qëllimi dhe rezultatet e pritshme, bartësi ose mentori, kohëzgjatja, burimet dhe mënyra e përcjelljes formative. Efektet e tyre shqyrtohen në raport me profilin individual dhe qëllimet zhvillimore, ndërsa njohuritë e fituara shërbejnë për përshtatjen e mësimit dhe rishikimin e mbështetjes, në mënyrë që aktivitetet të mos përbëjnë vetëm shtim të ngarkesës me obligime.

Kur shkolla nuk ka ekspertizën ose kushtet e përshtatshme, vendos bashkëpunim me një shkollë tjetër, institucion të arsimit të lartë ose institucion shkencor, institucion kulturor, organizatë sportive, shoqatë të akredituar, subjekt ekonomik ose partner tjetër përkatës. Bashkëpunimi mund të përfshijë mentorim të jashtëm, punë laboratorike dhe hulumtuese, shfrytëzimin e pajisjeve të specializuara, pjesëmarrjen në programe dhe projekte, si dhe ndërlidhjen me nxënës të tjerë me interesa të përafërta.

Shkolla e ruan përgjegjësinë për mbështetjen edhe kur aktivitetet realizohen jashtë saj. Për partnerin ose mentorin e jashtëm verifikohen profesionalizmi dhe përshtatshmëria për punë me fëmijë, ndërsa përcaktohen qëllimi, mbikëqyrja, siguria, përgjegjësia, konfidencialiteti, shfrytëzimi i punimeve të nxënësit/nxënëses dhe pronësia intelektuale, kompensimi eventual, informacioni kthyes dhe kushtet për ndërprerjen e angazhimit. Nxënësi dhe prindi/kujdestari informohen për aktivitetin, personat përgjegjës dhe mënyrën e përdorimit të të dhënave. Pëlqimi i nevojshëm për pjesëmarrje, vlerësim të specializuar ose shkëmbim të të dhënave përcaktohet sipas qëllimit konkret dhe dispozitave të zbatueshme, në përputhje me kapitullin VI.3.

Mbështetja bazë shkollore sigurohet pa shpenzime për familjen. Qasja planifikohet në mënyrë të veçantë për nxënësit nga shkollat e vogla dhe shkollat periferike, nga mjediset rurale dhe të largëta, si dhe për ata/ato, familjet e të cilëve nuk mund t'i mbulojnë shpenzimet për mundësi shtesë. Mund të shfrytëzohen bashkëpunimi ndërmjet shkollave, programet rajonale, mentorimi digjital, burimet e përbashkëta dhe mbështetja financiare ose logjistike. Shkollat me kapacitete të kufizuara profesionale përfshihen në këto forma bashkëpunimi, me persona përgjegjës të përcaktuar qartë dhe pa ia bartur organizimin familjes.

Në bashkëpunim ndërmjet institucioneve kompetente, njësive të vetëqeverisjes lokale, shkollave, institucioneve të arsimit të lartë dhe institucioneve shkencore, si dhe partnerëve të tjerë përkatës, mund të zhvillohen programe, aktivitete hulumtuese, shkolla verore, kampe dhe forma të tjera të mbështetjes në nivel kombëtar ose rajonal.

V.4. Garat, manifestime dhe prezantimi publik i arritjeve

Garat, manifestimet dhe format e tjera të prezantimit publik u mundësojnë nxënësve të punojnë drejt arritjes së qëllimeve sfiduese, të takohen me bashkëmoshatarë që kanë interesa të ngjashme, të marrin informacione kthyese profesionale dhe të prezantojnë njohuritë, shkathtësitë, rezultatet e hulumtimeve, krijimet dhe performancat e tyre.

Në arsimin fillor, garat në lëndë të veçanta organizohen në përputhje me rregulloren e posaçme për mënyrën dhe kriteret më të hollësishme të organizimit dhe zhvillimit të tyre në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror, si dhe përmes shoqatave të mësimdhënësve që kanë akreditimin përkatës.[18]

Shkolla i informon nxënësit për mundësitë e disponueshme, siguron procedurë të drejtë për përfshirje dhe organizon përgatitje profesionale dhe mentorim.

Pjesëmarrja është vullnetare dhe bazohet në interesimin, gatishmërinë dhe mirëqenien e nxënësit/nxënëses.
Rezultati në garë është tregues përkatës i arritjeve në një fushë të caktuar, por nuk është kusht i detyrueshëm për identifikimin ose mbështetjen, e as dëshmi e vetme e dhuntisë dhe talentit. Mbështetje u ofrohet edhe nxënësve/nxënëseve, potenciali i të cilëve shprehet përmes punës hulumtuese afatgjatë, zgjidhjeve inovative, krijimeve artistike, performancave, projekteve ose formave të tjera që nuk përfshihen në gara.

Përgatitja nuk duhet të kufizohet në ushtrime afatshkurtra për arritjen e rezultatit. Ajo ndërlidhet me të nxënit e thelluar, zhvillimin e pavarësisë, kreativitetit dhe këmbënguljes, si dhe me aftësimin e nxënësit për t'u përballur si me suksesin, ashtu edhe me mossuksesin. Kur është e nevojshme, sigurohen përshtatje të arsyeshme për nxënësit me përjashtim të dyfishtë dhe për nxënësit me aftësi të kufizuara, në përputhje me rregullat në fuqi.

Shkolla i evidenton aktivitetet dhe arritjet përkatëse në portofolin e nxënësit dhe, kur parashikohet, në shtojcën e dëftesës dhe në dokumentacionin tjetër të përcaktuar pedagogjik, si dhe i merr parasysh gjatë planifikimit dhe rishikimit të mbështetjes. Nëse rezultati krijon të drejtën për shpërblim ose mbështetje tjetër, shkolla e informon me kohë nxënësin dhe prindin/kujdestarin dhe u siguron mbështetjen e nevojshme dokumentacionale.

V.5. Planifikimi individual, mentorimi dhe mbështetja socio-emocionale

Kur nevojat e nxënësit kërkojnë punë afatgjatë, më komplekse ose të koordinuar, ekipi i shkollës, së bashku me nxënësin dhe prindin/kujdestarin, harton plan individual për mbështetjen edukativo-arsimore. Ky është një dokument pedagogjik që ndërlidh profilin me masat mbështetëse dhe nuk e zëvendëson planin individual arsimor të sistemit të arsimit gjithëpërfshirës. Te përjashtimi i dyfishtë, harmonizohen qëllimet për zhvillimin e potencialit me masat për qasje dhe mbështetjen e vështirësive. Kur zbatohet PIA, ekipet e përfshira i harmonizojnë aktivitetet, personat përgjegjës dhe afatet për shqyrtim, duke respektuar statusin juridik të secilit dokument. Të dhënat e përbashkëta shfrytëzohen përmes ndërlidhjes së dokumentacionit, pa mbledhur sërish të njëjtat të dhëna dhe pa dyfishuar detyra identike për nxënësin, familjen dhe mësimdhënësit.

Plani përmban vlerësimet fillestare pedagogjike ose përmbledhjen e profilit individual; fushën e potencialit; interesat dhe nevojat; qëllimet zhvillimore dhe arsimore; përshtatjet në mësimdhënie dhe aktivitetet e tjera; mbështetjen mentorike dhe këshillëdhënëse; personat përgjegjës, burimet dhe afatin kohor; treguesit dhe mënyrat e përcjelljes formuese; si dhe periudhën për rishikim. Shtrirja e tij është proporcionale: formë e shkurtër për masa të thjeshta dhe plan më i detajuar për punë afatgjatë me disa persona përgjegjës. Mësimdhënësit i përfshijnë masat e dakorduara në planifikimin dhe punën e tyre, ndërsa ekipi i shkollës, bazuar në dëshmitë për përparimin, koordinon rishikimin e qëllimeve dhe të mbështetjes.

[18]Ministria e Arsimit dhe Shkencës. (2020). *Rregullore për mënyrën dhe kriteret më të afërta të organizimit dhe realizimit të garave të nxënësve sipas lëndëve të veçanta në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror në arsimin fillor.* Nr. 18-6753/1 nga 6.7.2020, me ndryshimet dhe plotësimet nr. 18-3228/1 nga 22.2.2021 dhe nr. 12-3710/1 nga 29.3.2024. Ministria e Arsimit dhe Shkencës. (2021). *Rregullore për formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës për marrjen e akreditimit të shoqatave të arsimtarëve për organizimin e garave për nxënësit në shkollat fillore.* "Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 41/2021.

Mentori i shkollës mund të jetë mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional me kompetenca përkatëse dhe njohuri në fushën përkatëse. Ai e ndihmon nxënësin/nxënësen të përcaktojë qëllime zhvillimore, dakordon detyra dhe projekte, siguron informacione kthyese dhe koordinon punën me mësimdhënësit e tjerë dhe me ekipin e shkollës. Kur niveli i nevojshëm i ekspertizës nuk është i disponueshëm në shkollë, angazhohet mentor i jashtëm nga ndonjë universitet, institut, institucion shkencor, kulturor, artistik, sportiv ose institucion tjetër përkatës.

Mentorimi është udhëheqje profesionale dhe zhvillimore e orientuar në një fushë të caktuar, me qëllime, dinamikë dhe mënyrë të përcjelljes të dakorduara. Ekipi i shkollës propozon mentorin sipas nevojave të nxënësit/nxënëses dhe kompetencave përkatëse, ndërsa drejtori e organizon angazhimin në përputhje me dispozitat në fuqi dhe bashkëpunimin e dakorduar. Mund të zbatohet individualisht, në grup të vogël ose përmes bashkëpunimit përkatës në distancë. Në udhëzimet për mentorimin shtjellohen përzgjedhja, aftësimi, mbikëqyrja dhe përgjegjësitë, si dhe një model i rrjetit të mentorimit ndërmjet shkollave, në nivel rajonal dhe kombëtar, me mundësi të punës në distancë. Roli i mentorit në mbështetjen e nxënësit dallon nga titulli i rregulluar me ligj mësimdhënës-mentor.

Shkolla e mbështet mirëqenien përmes krijimit të një mjedisi të sigurt, pranimit të dallimeve, ofrimit të sfidave të përshtatshme dhe zhvillimit të shkathtësive sociale dhe emocionale. Potenciali i lartë në vetvete nuk nënkupton vështirësi socio-emocionale. Kur vërehen perfeksionizëm joadaptues, ankth, motivim i ulët, përjetim i mospranimit ose vështirësi në marrëdhëniet me bashkëmoshatarët, sigurohet mbështetje e orientuar këshillëdhënëse sipas nevojave.

Psikologu, pedagogu dhe bashkëpunëtorët profesionalë kontribuojnë në punën këshillëdhënëse në kuadër të kompetencave të tyre dhe në bashkëpunim me mësimdhënësin dhe mentorin. Ajo mund të përfshijë qëllime zhvillimore, vetërregullimin, interesat, përballimin e mossuksesit dhe përzgjedhjen e mundësive të mëtejshme. Te përjashtimi i dyfishtë mbështeten të kuptuarit e pikave të forta dhe nevojave personale, vetëbesimi realist dhe shprehja e nevojave personale. Kur nxënësi e fsheh potencialin për t'u pranuar nga bashkëmoshatarët, mësimdhënësi dhe psikologu dakordojnë mbështetjen për ndjenjën e përkatësisë dhe shprehjen e sigurt të aftësive. Për nevojat që tejkalojnë kapacitetet e shkollës organizohet bashkëpunimi ose referimi te shërbimi përkatës profesional, duke informuar dhe përfshirë familjen.

Prindërit/kujdestarët marrin informacione dhe mundësi për këshillim, punëtori dhe shkëmbim përvojash, përfshirë edhe përmes formave të ”shkollës për prindër“, të përshtatura sipas nevojave të shkollës. Përforcohet mbështetja e tyre për interesat, pavarësinë dhe mirëqenien e nxënësit/nxënëses, pa krijuar presion të pajustifikuar për arritje. Mekanizmat e vendosur për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndërmjet bashkëmoshatarëve zbatohen në të gjitha format e punës brenda dhe jashtë shkollës.

V.6. Përparimi i përshpejtuar

Përparimi i përshpejtuar është një mundësi e veçantë për nxënësin që i përvetëson dukshëm më shpejt përmbajtjet e parapara dhe për të cilin pasurimi dhe thellimi i të nxënit me ritmin e zakonshëm nuk paraqesin sfidë të mjaftueshme zhvillimore. Zbatohet kur është në interesin më të mirë të nxënësit, kur është i arsyetuar profesionalisht dhe kur plotësohen kushtet dhe procedura e përcaktuar me nenin 145 të Ligjit për Arsimin Fillor dhe dispozitat e tjera në fuqi. Gjatë vlerësimit merren parasysh njohuritë dhe aftësitë, motivimi, mendimi i nxënësit dhe i prindërve/kujdestarëve, kushtet për vazhdimin e mbështetjes dhe mundësia e zhvillimit asinkron kognitiv, emocional dhe social. Përjashtimi i dyfishtë ose zhvillimi i pabarabartë nuk përbëjnë në vetvete arsye për përjashtimin nga shqyrtimi i kësaj mase; vlerësohen gatishmëria individuale dhe përshtatjet e nevojshme për zbatimin e saj me sukses.

Si mundësi mund të shqyrtohen përparimi i përshpejtuar në një lëndë të caktuar, regjistrimi i parakohshëm ose kalimi në një klasë më të lartë. Përmendja e këtyre mundësive nuk krijon të drejtë ose mundësi të drejtpërdrejtë për zbatimin e tyre. Secila prej këtyre formave mund të zbatohet vetëm nëse lejohet dhe rregullohet me

dispozitat ligjore dhe procedurat përkatëse në fuqi. Për kalimin në klasën pasuese zbatohet neni 145, i cili parasheh propozimin e mësimdhënësit kujdestar të klasës, pëlqimin e prindit ose kujdestarit ligjor, vendimin e këshillit të arsimtarëve dhe plotësimin e kushteve të tjera ligjore, duke siguruar njëkohësisht mbështetje mentorimi dhe këshillëdhënëse.

Vendimi ndërlidhet me një plan për përgatitjen, përcjelljen dhe mbështetjen në mjedisin e ri. Në periudhën fillestare sigurohet përcjellje e shtuar e përshtatjes, si dhe ndihmë mentorimi dhe këshillimore. Ekipi i shkollës shqyrton periodikisht efektet akademike, sociale dhe emocionale dhe propozon vazhdimin, përshtatjen ose rishqyrtimin e masës në përputhje me dispozitat në fuqi, pa e interpretuar përshtatjen e mbështetjes si mossukses personal të nxënësit. Gjatë plotësimit të mëtejshëm të rregullimit të sistemit, është e nevojshme që me udhëzim të posaçëm profesional të përcaktohen kriteret, procedura, dokumentacioni i nevojshëm dhe përgjegjësitë për format e ndryshme të përparimit të përshpejtuar.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byroja e Zhvillimit të Arsimit i shqyrtojnë parakushtet normative dhe profesionale për format që nuk janë rregulluar mjaftueshëm dhe, kur është e nevojshme, propozojnë plotësimin përkatës të rregullimit para zbatimit të tyre.

Për nxënësit me potencial të shprehur jashtëzakonisht të lartë, njohuritë, aftësitë dhe arritjet e të cilëve tejkalojnë dukshëm nivelin e paraparë për moshën dhe klasën, planifikohet një rrugë individuale zhvillimore. Ajo mund të përfshijë program të thelluar dhe të zgjeruar, mentorim, pjesëmarrje në aktivitete të nivelit më të lartë arsimor, bashkëpunim me ekspertë të jashtëm dhe, kur plotësohen kushtet ligjore dhe profesionale, përparim të përshpejtuar.

V.7. Nxitja, shpërblimet dhe bursat

Njohja e arritjeve dhe mbështetja materiale paraqesin masa shtesë për nxitje, por nuk e zëvendësojnë mbështetjen e vazhdueshme edukativo-arsimore. Qëllimi i tyre është të nxisin zhvillimin e mëtejshëm, të zvogëlojnë pengesat financiare dhe të mundësojnë qasje në programe, pajisje, literaturë, udhëtime, gara dhe mundësi të tjera zhvillimore.

Të drejtat që lidhen me shpërblimin realizohen në përputhje me rregulativen ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe procedurat e përcaktuara. Shkolla zbaton lavdërimet, shpërblimet, diplomat dhe mirënjohjet e parapara. Kontributi i mësimdhënësve dhe mentorëve njihet në kuadër të mekanizmave në fuqi; shpërblimet në të holla realizohen sipas kategorive, kritereve dhe procedurave ligjore. Shkolla, në kuadër të kompetencave të saj, e informon nxënësin dhe prindin/kujdestarin, e vërteton dokumentacionin që lëshon dhe siguron mbështetjen e nevojshme gjatë aplikimit.[19]

Dhënia e bursave realizohet në përputhje me Ligjin për Standardin e Nxënësve, programet vjetore, konkurset dhe dispozitat e tjera në fuqi, të cilat përcaktojnë kategoritë e përfituesve, kushtet, kriteret dhe procedurën. Shkolla, ekipi i shkollës dhe institucionet kompetente i informojnë nxënësit dhe i ndërlidhin me programet e disponueshme kombëtare, lokale, të donatorëve dhe programet e tjera legjitime për mbështetje financiare, veçanërisht gjatë kalimit në arsimin e mesëm.[20]

---

[19] Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2019). *Ligji për Arsimin Fillor*. "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 161/2019, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme, nenet 44 dhe 75.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës. (2025). *Rregullore për mënyrën e ndarjes së shpërblimit në shumë të vetme për nxënësin e talentuar dhe të dhuntishëm të arsimit fillor, i cili ka marrë pjesë në olimpiadë ose garë ndërkombëtare të organizuar për nxënësit e arsimit të mesëm dhe ka fituar çmimin e parë, të dytë ose të tretë, përkatësisht medaljen e artë, të argjendtë ose të bronztë, si dhe për nxënësin që ka marrë pjesë dhe ka fituar vendin e parë në garë në nivel shtetëror për nxënësit e arsimit të mesëm*. Nr. 18-9669/1, më 07.07.2025.

[20] Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. (2005). *Ligji për Standardin e Nxënësve*. "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 52/2005, me ndryshimet dhe plotësimet e

mëvonshme. Zbatohen gjithashtu programet vjetore dhe konkurset përkatëse për realizimin e të drejtave që burojnë nga standardi i nxënësve.

Gjatë propozimit dhe ndarjes së mbështetjes sigurohen kritere transparente dhe qasje e barabartë. Përveç arritjeve, duhet të merren parasysh edhe shpenzimet reale për zhvillimin e potencialit dhe rreziku që nxënësi të mbetet pa qasje për shkak të rrethanave sociale, ekonomike ose gjeografike.

Mundësitë për sigurimin e mbështetjes shtesë materiale shqyrtohen në bazë të nevojave të identifikuara, mjeteve financiare në dispozicion dhe kompetencave të institucioneve përkatëse. Në kuadër të planit të zbatimit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), në bashkëpunim me Byronë e Zhvillimit të Arsimit (BZHA) dhe institucionet e tjera kompetente, vlerëson mundësinë e ofrimit të ndihmës së synuar, duke përfshirë mini-bursat ose vauçerët për blerjen e librave, materialeve mësimore, ndjekjen e kurseve dhe pjesëmarrjen në programe të ndryshme. Zbatimi i këtyre masave kushtëzohet nga përcaktimi i institucionit përgjegjës, kritereve të përfitimit, burimeve të financimit dhe bazës përkatëse normative.

V.8. Organizimi, rolet dhe monitorimi i mbështetjes

Shkolla i përfshin masat dhe aktivitetet në programin zhvillimor dhe programin vjetor të punës dhe siguron kushtet për realizimin e tyre. Drejtori siguron kushtet organizative, kohën për punë ekipore dhe mentorim, ndarjen e përgjegjësive, burimet e nevojshme dhe partneritetet me subjekte të jashtme, në kuadër të detyrimeve të punës në fuqi dhe burimeve të siguruara. Në planin e zbatimit vlerësohen koha e nevojshme e punës, mbështetja kadrovike dhe implikimet financiare; shqyrtohen normimi, vlerësimi dhe kompensimi eventual për angazhimin shtesë. Rregullimi i nevojshëm sigurohet para vendosjes së detyrimeve të reja. Shkolla dhe themeluesi, në kuadër të kompetencave të tyre, i planifikojnë dhe sigurojnë materialet, hapësirën dhe logjistikën e nevojshme; shpenzimet për mbështetjen bazë shkollore nuk u ngarkohen mësimdhënësve ose familjes.

Ekipi i shkollës bashkërendit kombinimin e dakorduar të masave, përcakton mënyrën e ndjekjes dhe shqyrton efektin e mbështetjes. Mësimdhënësit, mentorët dhe bashkëpunëtorët profesionalë i realizojnë detyrat në kuadër të kompetencave të tyre profesionale dhe përgjegjësive të përcaktuara në kapitullin VI.1.

Nxënësi merr pjesë në përcaktimin e qëllimeve, përzgjedhjen e aktiviteteve dhe vlerësimin e përparimit të vet, në përputhje me moshën dhe pjekurinë. Prindi/kujdestari informohet, merr pjesë në planifikim dhe jep informacione kthyese për interesat, ngarkesën dhe efektet e mbështetjes, pa ia bartur familjes përgjegjësinë për sigurimin e masave mbështetëse shkollore.

Përcjellja verifikon ndërlidhjen ndërmjet njohurive fillestare ose profilit individual, qëllimeve zhvillimore, përshtatjeve të zbatuara dhe rezultateve të arritura. Mësimdhënësi, mentori dhe bashkëpunëtorët profesionalë i shfrytëzojnë informacionet kthyese nga vlerësimi formues për vazhdimin, ndryshimin, zgjerimin ose zvogëlimin gradual të masave. Fushat dhe treguesit për përcjelljen e nxënësit/nxënëses, përfshirë edhe rastet e përjashtimit të dyfishtë, janë përcaktuar në kapitullin VIII.1.

Vazhdimësia e masave, bartja e njohurive përkatëse dhe marrja përsipër e përgjegjësive gjatë kalimeve ndërmjet cikleve, shkollave dhe niveleve të arsimit sigurohen në përputhje me përcaktimet e kapitullit VII.

V.8. Dokumentet profesionale dhe kushtet për zbatim

Për zbatimin e masave përgatiten udhëzime dhe shembuj për punën edukativo-arsimore, formularë për planifikim individual proporcional, udhëzime për mbështetjen këshillëdhënëse, mentorimin dhe bashkëpunimin e jashtëm, si dhe udhëzim profesional për përparimin e përshpejtuar. Ato ndërlidhen me dokumentet për punën ekipore, zhvillimin profesional, të dhënat dhe përcjelljen, të renditura në Shtojcën 1, veçanërisht dokumentet 11–22 dhe 25. Materialet duhet të përmbajnë shembuj të shtjelluar dhe të plotësuar sipas fushave, periudhave zhvillimore dhe kushteve të ndryshme shkollore: verifikimin e përvetësimit paraprak, përzgjedhjen e përshtatjeve, kriteret për vlerësimin formativ dhe rishqyrtimin e masave. Në to paraqitet ndërlidhja ndërmjet profilit, qëllimit, aktivitetit dhe përparimit të pritshëm.

Në planin e zbatimit përcaktohen bartësit, afatet, burimet e nevojshme financiare, kadrovike dhe materiale, mënyra e pilotimit dhe përcjellja e zbatimit. Vlerësimi financiar hartohet sipas fazave, duke përcaktuar prioritetet për shkollat dhe nxënësit/nxënëset me burime të kufizuara. Çështjet që krijojnë të drejta, detyrime, autorizime ose implikime të reja financiare rregullohen më hollësisht me akte përkatëse ligjore dhe nënligjore para zbatimit të tyre të rregullt.

VI. MENAXHIMI, ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Kujdesi për zhvillimin e nxënësve të talentuar dhe të dhuntishëm është përgjegjësi e përbashkët e sistemit arsimor, shkollës, familjes dhe mjedisit më të gjerë shoqëror. Me këtë Koncept vendoset një sistem i ndërlidhur, në të cilin secili pjesëmarrës vepron në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive të veta, ndërsa nxënësi, zhvillimi dhe mirëqenia e tij janë në qendër të të gjithë procesit.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës siguron kushtet normative, programore dhe financiare për zbatimin e Konceptit, si dhe koordinon ndërlidhjen e tij me politikat e tjera në fushën e arsimit fillor. Byroja e Zhvillimit të Arsimit, në përputhje me kompetencat e saj, siguron bazën profesionale dhe zhvillimore përmes hartimit dhe avancimit të metodologjive, udhëzimeve, instrumenteve dhe materialeve profesionale, organizimit të zhvillimit profesional dhe ofrimit të mbështetjes këshillëdhënëse për shkollat, si dhe monitorimit të zbatimit të Konceptit.[21]

Themeluesit e shkollave kontribuojnë në sigurimin e kushteve hapësinore, organizative, materiale dhe teknike, si dhe në ndërlidhjen e shkollave me burimet dhe mundësitë që ofron mjedisi lokal. Në kuadër të mundësive të tyre, ata mbështesin qasjen e barabartë në aktivitete, mentorim, gara dhe mundësi të tjera zhvillimore, veçanërisht për nxënësit nga mjediset me burime të kufizuara.

Shkolla është bartësi kryesor i përgjegjësisë për identifikimin dhe zhvillimin e potencialit të nxënësit, ndjekjen e përparimit të tij, planifikimin dhe realizimin e mbështetjes, si dhe bashkërendimin e procesit të identifikimit. Kur paraqitet nevoja për bashkëpunim me profesionistë ose institucione të jashtme, shkolla përcakton dhe arsyeton qëllimin e këtij bashkëpunimi dhe përcjell vetëm informacionet e domosdoshme, në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale. Mbështetja organizohet brenda shkollës, kur kjo është e mundur, ndërsa sipas nevojës bëhet edhe referimi te institucionet kompetente. Institucioni kompetent ose i autorizuar siguron vlerësimin përkatës profesional dhe jep rekomandime për punën edukativo-arsimore, duke specifikuar edhe kufizimet përkatëse. Ekipi i shkollës i shqyrton këto rekomandime së bashku me mësimdhënësin, nxënësin dhe prindërit ose kujdestarët ligjorë, i ndërlidh me masat e dakorduara dhe bashkërendon monitorimin e zbatimit të tyre. Bashkëpunimi me profesionistët dhe institucionet e jashtme e plotëson punën profesionale të shkollës, ndërsa përgjegjësia për sigurimin e mbështetjes së përditshme mbetet te shkolla.

Proceset përfshihen në programin zhvillimor dhe programin vjetor të punës, në planifikimin e mësimdhënies, në punën e organeve dhe trupave profesionalë, si dhe në mekanizmat ekzistues për vetëvlerësimin dhe zhvillimin e shkollës. Në këtë mënyrë nuk vendoset një sistem paralel, por sigurohet veprimi i harmonizuar i strukturave ekzistuese shkollore dhe sistemore.

VI.1. Ekipi i shkollës dhe bashkërenduesi për nxënësit e talentuar dhe të dhuntishëm

Në shkollë themelohet ekipi i shkollës për nxënësit e talentuar dhe të dhuntishëm, i cili ka rol bashkërendues dhe profesional. Ekipi ndërlidh punën e mësimdhënësve/mësimdhënëseve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe udhëheqësisë së shkollës, integron njohuritë në dispozicion, propozon mbështetje edukativo-arsimore dhe siguron vazhdimësi ndërmjet identifikimit fillestar, identifikimit të thelluar, planifikimit, realizimit dhe përcjelljes. Ai nuk i merr përsipër kompetencat profesionale të anëtarëve dhe as autorizimet e organeve që marrin vendime në përputhje me ligjin.

[21] Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. (2006). *Ligji i Byrosë së Zhvillimit të Arsimit.* "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 37/2006, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2019). *Ligji për Arsimin Fillor.* "Gazeta Zyrtare e Republikës së maqedonisë së Veriut", nr. 161/2019, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme.

Shkolla e përcakton përbërjen, koordinatorin dhe mandatin e ekipit në mënyrën e përcaktuar me ligj, akt nënligjor ose me akt tjetër përkatës të miratuar për zbatimin e Konceptit. Ekipi ka një bërthamë të vogël të përhershme koordinuese, të përbërë nga mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë. Në shqyrtimin e rastit të një nxënësi konkret përfshihen personat që punojnë drejtpërdrejt me të dhe profilet profesionale të nevojshme, sipas moshës, fushës dhe nevojave. Sipas nevojës, përfshihen mentori dhe ekspertë të jashtëm, me rol të përcaktuar, detyrim për ruajtjen e konfidencialitetit dhe procedurë veprimi në rast të konfliktit të mundshëm të interesave. Bashkëpunimi me ekipet ekzistuese të shkollës parandalon dyfishimin e detyrave dhe dokumentacionit.

Drejtori, në konsultim me anëtarët e ekipit, e përcakton koordinatorin në bazë të kompetencave, përvojës, përbërjes kadrovike dhe kushteve organizative në shkollë. Koordinatori i organizon takimet, e mbështet shkëmbimin e informacioneve të domosdoshme, e përcjell realizimin e detyrave të dakorduara dhe siguron ndërlidhjen me nxënësin, prindërit/kujdestarët, mentorët dhe institucionet e jashtme.

Kur për nxënësin përfshihen edhe ekipet për mbështetje gjithëpërfshirëse, koordinatori, në marrëveshje me to, siguron përcaktimin e qartë të personit përgjegjës për komunikimin e ndërsjellë dhe për ndërlidhjen me familjen. Personat e përfshirë i shqyrtojnë bashkërisht qëllimet, ndarjen e detyrave dhe efektet e mbështetjes, secili në kuadër të kompetencave të veta. Ky koordinim përfshihet në punën ekzistuese ekipore, pa formuar ekip shtesë për të njëjtin nxënës.

Ekipi:

- i shqyrton të dhënat për identifikimin, zhvillimin dhe përcjelljen e potencialit;
- e koordinon mbledhjen e gjetjeve shtesë profesionale, kur është e nevojshme;
- propozon dhe harmonizon masat dhe aktivitetet në përputhje me profilin individual të nxënësit/nxënëses;
- propozon personat përgjegjës për zbatimin e mbështetjes, si dhe mentorin ose personin tjetër përgjegjës për mbështetjen konkrete;
- shqyrton planin individual të mbështetjes dhe zbatimin e tij;
- përcjell disponueshmërinë e mbështetjes, ngarkesën, përparimin dhe mirëqenien e nxënësit/nxënëses;
- propozon përshtatjen e mbështetjes dhe, kur është e nevojshme, vlerësimin shtesë profesional ose vlerësimin nga ekspertë të jashtëm;
- siguron vazhdimësinë gjatë kalimit në një periudhë tjetër arsimore, në një shkollë tjetër ose në një nivel tjetër të arsimit.

Përgjegjësitë profesionale përcaktohen sipas natyrës së detyrës. Vendimet organizative, ligjore dhe financiare i marrin organet dhe personat kompetentë, ndërsa secili profil profesional mban përgjegjësi për vlerësimin dhe punën që realizon.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja bën vëzhgime sistematike, përdor mjete të përshtatshme pedagogjike, siguron mundësi të diferencuara për të nxënë, mbledh dëshmi dhe përcjell efektin e mbështetjes. Pedagogu analizon kontekstin edukativo-arsimor dhe kontribuon në vlerësimin pedagogjik të nevojave të nxënësit. Ai bashkërendit komponentin pedagogjik të planifikimit dhe u ndihmon mësimdhënësve dhe aktiveve profesionale në përzgjedhjen e përshtatjeve didaktike, ndërlidhjen e aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore, vlerësimin formativ dhe rishqyrtimin e masave. Koordinimi i ekipit të shkollës përcaktohet në bazë të kushteve të përcaktuara në këtë kapitull dhe nuk lidhet automatikisht me një profil të caktuar profesional.

Psikologu/psikologia planifikon, realizon dhe interpreton vlerësimin psikologjik, përdor instrumente të përshtatshme dhe të lejuara, kujdeset për ruajtjen e konfidencialitetit të protokoleve psikologjike dhe siguron mbështetje këshillimore. Kur është e nevojshme, propozon mbikëqyrje profesionale, mendim të dytë profesional ose referim te shërbimet e jashtme. Edukatori special dhe rehabilituesi/edukatorja speciale dhe rehabilituesja, si dhe bashkëpunëtorët e tjerë profesionalë, përfshihen sipas nevojave të nxënësit/nxënëses, veçanërisht për sigurimin e qasjes dhe harmonizimin e mbështetjes në rastin e dyfishimit të veçantisë.

Drejtori siguron organizimin, veprimin në përputhje me ligjin, kushtet për mbrojtjen e të dhënave, kohën brenda detyrimeve të punës, burimet, zhvillimin profesional dhe partneritetet. Ai është përgjegjës për funksionimin organizativ dhe llogaridhënien e shkollës, pa zëvendësuar vlerësimet profesionale të personave kompetentë.

Nxënësi, në përputhje me moshën dhe pjekurinë, ka të drejtë të informohet, të shprehë mendimin e tij, të marrë pjesë në përcaktimin e qëllimeve dhe aktiviteteve dhe të kërkojë rishqyrtim.

Prindërit dhe kujdestarët ligjorë janë burim i rëndësishëm informacioni dhe partnerë në procesin e planifikimit. Ata kanë qasje në gjetjet profesionale, në përputhje me dispozitat përkatëse, dhe japin pëlqimin vetëm në rastet kur kjo kërkohet me ligj. Mospajtimi i tyre shqyrtohet sipas procedurës së përcaktuar, pa ia kaluar familjes përgjegjësinë për sigurimin e mbështetjes në shkollë.

Me aktet përkatëse normative rregullohen formimi zyrtar i ekipit, mandati dhe përgjegjësitë e tij. Protokolli kombëtar dhe udhëzimet shoqëruese përcaktojnë më hollësisht dinamikën e punës, pjesëmarrjen e profileve të nevojshme profesionale, procedurat e vendimmarrjes, mbajtjen e procesverbalit, nënshkrimin e propozimit të integruar profesional, trajtimin e konfliktit të interesit, si dhe veprimin në rast të dallimeve në mendime ose të mospajtimeve. Dokumentacioni mbahet në formë të përmbledhur dhe funksionale, duke u ndërlidhur me evidencat ekzistuese (Shtojca 1, dokumentet 2, 9 dhe 17).

Zhvillimi profesional dhe burimet

Cilësia e sistemit varet nga kompetencat e mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, drejtorëve, bashkërenduesve dhe mentorëve. Për këtë arsye, puna me nxënësit e talentuar dhe të dhuntishëm përfshihet në sistemin ekzistues të zhvillimit profesional, në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet e kompetencave profesionale të kuadrit edukativo-arsimor.[22]

Gjatë hartimit të sistemit, shqyrtohen kompetencat ekzistuese profesionale në fushat e identifikimit të nevojave individuale, planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies, mbështetjes së të nxënit, ndjekjen, bashkëpunimit dhe zhvillimit profesional të vazhdueshëm. Në bazë të këtij shqyrtimi, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), në bashkëpunim me Byronë e Zhvillimit të Arsimit (BZHA) dhe institucionet përkatëse profesionale, propozon plotësimin dhe harmonizimin e standardeve dhe akteve përkatëse, aty ku vlerësohet e nevojshme, me qëllim që puna me nxënësit me potencial të lartë dhe me veçori të dyfishta të përfshihet në mënyrë më të qartë.

Zhvillimi profesional orientohet drejt identifikimit të mënyrave të ndryshme të shfaqjes së potencialit të lartë; vëzhgimit sistematik dhe përdorimit të burimeve të shumta; diferencimit, individualizimit, pasurimit dhe thellimit; të nxënit përmes projekteve, zgjidhjes së detyrave dhe hulumtimit; planifikimit individual dhe mentorimit; mbështetjes socio-emocionale; partneritetit me prindërit; punës ekipore dhe përcjelljes së efekteve. Përmbajtjet që lidhen me dyfishimin e veçantisë përfshijnë mbulimin e ndërsjellë të aftësive dhe vështirësive, mënyrat e qasshme të vlerësimit në kuadër të kompetencave profesionale, diferencimin e dyfishtë dhe harmonizimin e mbështetjes me ekipet gjithëpërfshirëse.

[22] Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2019). *Ligji për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme.* ”Gazeta Zyrtare e RMV-së”, nr. 161/2019, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Zbatohen edhe aktet nënligjore për kompetencat profesionale dhe zhvillimin profesional.

Për psikologët dhe personat e tjerë që përdorin instrumente të specializuara sigurohet aftësim shtesë, në përputhje me standardet profesionale dhe kushtet për përdorimin e instrumenteve. Për drejtorët dhe bashkërenduesit apo koordinatorët sigurohen përmbajtje që lidhen me organizimin, menaxhimin e ligjshëm të të dhënave, ndarjen e përgjegjësive dhe burimeve, partneritetet, punën ekipore dhe llogaridhënien.

Byroja e Zhvillimit të Arsimit i përcakton nevojat dhe siguron bazën profesionale për zhvillimin e vazhdueshëm profesional. Në përputhje me Ligjin e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, programet dhe ofruesit e trajnimeve përzgjidhen dhe akreditohen përmes procedurave të përcaktuara, ndërsa programet e akredituara publikohen në katalogun përkatës. Në këtë kuadër zhvillohen trajnime për njohjen, identifikimin brenda kompetencave profesionale dhe punën edukativo-arsimore me nxënësit e talentuar dhe të dhuntishëm.[23]

Zhvillimi profesional përfshin përmbajtjet bazë dhe të avancuara, sipas rolit dhe kompetencave paraprake. Trajnimet ndërlidhen me zbatimin praktik, analizën e rasteve, hartimin e detyrave dhe materialeve, mbështetjen këshillimore dhe mentorimin, si dhe të nxënit ndërmjet kolegëve. Monitorohet zbatimi në shkollë dhe jo vetëm pjesëmarrja në trajnim. Aftësimi i specializuar për përdorimin e instrumenteve psikologjike respekton kualifikimet, licencat dhe kushtet e përdorimit të instrumentit.

Përmbajtjet për drejtorët harmonizohen me sistemin e trajnimit bazë dhe të avancuar për drejtorë/drejtoresha dhe shtjellohen në bashkëpunim me Qendrën Shtetërore të Provimeve dhe institucionet e tjera kompetente. Ato orientohen drejt udhëheqjes pedagogjike, kulturës gjithëpërfshirëse të shkollës, mbështetjes së ekipit, sigurimit të burimeve dhe përcjelljes së cilësisë së punës me nxënësit e talentuar dhe të dhuntishëm.[24]

Avansimi sistematik i mbështetjes nënkupton që përmbajtjet për njohjen, identifikimin dhe punën edukativo-arsimore me nxënësit/nxënëset e talentuar dhe të dhuntishëm të përfaqësohen në mënyrë përkatëse edhe në programet e studimit për arsimin fillestar të mësimdhënësve/mësimdhënëseve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë. Mundësia e zhvillimit të qendrave rajonale ose universitare të burimeve shqyrtohet në bazë të analizës së nevojave, kompetencave, kapaciteteve profesionale, qëndrueshmërisë dhe financimit.

Shkolla shfrytëzon burimet e veta njerëzore, organizative, materiale dhe digjitale dhe, kur ato nuk janë të mjaftueshme, vendos bashkëpunim me shkolla të tjera, institucione të arsimit të lartë dhe institucione shkencore, institucione të fushës së kulturës dhe sportit, shoqata të akredituara dhe partnerë të tjerë përkatës. Gjatë shpërndarjes së burimeve sigurohet qasje e drejtë, veçanërisht për nxënësit/nxënëset nga mjediset rurale, me kushte të pafavorshme sociale dhe ekonomike dhe nga mjedise të tjera me më pak mundësi për stimulim.

---

[23] Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. (2006). *Ligji për Byronë e Zhvillimit të Arsimit.* "Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 37/2006, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Neni 8, nenet 8-a–8-d dhe neni 13. Byroja e Zhvillimit të Arsimit. (2025). *Rregullore për përzgjedhjen dhe akreditimin e programeve të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve për përsosjen profesionale të kuadrit edukativo-arsimor (mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë) në shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut.* Nr. 01-333/5, më 22.04.2025.

[24] Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. (2015). *Ligji për trajnimin dhe provimin për drejtor të shkollës fillore, shkollës së mesme, konviktit të nxënësve dhe universitetit të hapur qytetar për mësim gjatë gjithë jetës*. "Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 10/2015, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës. (2022). *Programi për trajnim të avancuar të drejtorëve*. „Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 260/2022. Qendra Shtetërore e Provimeve. (2024). *Programi i punës për vitin 2024.* Pjesa për trajnimin bazë dhe të avancuar të drejtorëve.

VI.2. Dokumentacioni, evidenca dhe mbrojtja e të dhënave

Dokumentimi shërben për planifikimin profesional, përcjelljen e zhvillimit dhe sigurimin e vazhdimësisë së mbështetjes. Mblidhen vetëm të dhënat që janë të domosdoshme për qëllimin përkatës, pa krijuar administratë të panevojshme dhe evidenca paralele. Dokumentacioni dhe evidenca formale pedagogjike mbahen në përputhje me dispozitat që rregullojnë arsimin fillor.

Për nxënësin të cilit i sigurohet mbështetje e vazhdueshme dhe e planifikuar, krijohet një portofol zhvillimor. Në të përfshihen produkte të përzgjedhura të nxënësit, informacione për interesat dhe potencialet, vëzhgime përkatëse të mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe mentorëve, një përmbledhje pedagogjike e gjetjeve të nevojshme për mbështetjen, plani individual, nëse është hartuar, si dhe të dhënat për masat e zbatuara dhe efektet e tyre. Protokollet origjinale psikologjike dhe materialet e testeve të licencuara nuk janë pjesë e portofolit.

Portofoli zhvillimor ka funksion pedagogjik dhe zhvillimor. Ai nuk është instrument i pavarur për identifikim dhe nuk përbën evidencë të re formale. Në fazën fillestare mbahet në formë të thjeshtë dhe zgjerohet vetëm kur këtë e kërkon kompleksiteti dhe kohëzgjatja e mbështetjes.

Gjatë kalimit në një klasë tjetër, periudhë tjetër edukativo-arsimore, shkollë tjetër ose nivel tjetër të arsimit, në interesin më të mirë të nxënësit/nxënëses dhe mbi një bazë të përshtatshme ligjore, transferohen vetëm informacionet përkatëse të nevojshme për vazhdimësinë e mbështetjes, në përputhje me dispozitat për dokumentacionin pedagogjik, evidencën dhe mbrojtjen e të dhënave personale.[25]

Të dhënat nga vlerësimet psikologjike dhe vlerësimet e tjera profesionale janë konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë mbledhur. Qasje kanë vetëm personat e autorizuar, të cilëve këto të dhëna u nevojiten për kryerjen e detyrave profesionale. Protokollet profesionale dhe materialet e licencuara ruhen dhe përdoren në përputhje me rregullat profesionale dhe kushtet e përcaktuara nga botuesi dhe nuk përdoren për etiketimin, renditjen ose krahasimin publik të nxënësve.

Dokumentet për zbatim përcaktojnë strukturën e portofolit, formularët, personat përgjegjës, qasjen, afatet e ruajtjes, asgjësimin ose arkivimin dhe ndërlidhjen me dokumentacionin ekzistues pedagogjik. Drejtori siguron kushte organizative dhe teknike për veprim në përputhje me ligjin. Evidenca e re formale ose digjitale vendoset vetëm mbi një bazë përkatëse normative dhe me masa të përcaktuara për mbrojtjen e të dhënave. Nëse krijohet evidencë e përmbledhur digjitale, ajo përmban vetëm një grup minimal të dhënash të agreguara, të nevojshme për përcjelljen e përfshirjes, qasshmërisë dhe drejtësisë, pa përfshirë gjetje konfidenciale psikologjike.

[25] Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2019). *Ligji për arsimin fillor*. „Gazeta Zyrtare e RMV-së“, nr. 161/2019, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2020). *Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale.* „Gazeta Zyrtare e RMV-së“, nr. 42/2020, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Zbatohen edhe dispozitat për dokumentacionin dhe evidencën pedagogjike në arsimin fillor.

VII. TRANZICIONI DHE VAZHDIMËSIA E MBËSHTETJES

VII.1. Përcaktimi fillestar

Nevojat e nxënësit ndryshojnë gjatë procesit të shkollimit, veçanërisht kur zhvillimi i tij kognitiv, emocional dhe social ndodh me ritme të ndryshme. Vazhdimësia e mbështetjes nënkupton që gjatë çdo kalimi nga një nivel arsimor në tjetrin të shqyrtohen nevojat aktuale të nxënësit, si dhe kushtet dhe mundësitë që ofron mjedisi i ri arsimor.[26]

Kalimi në një klasë tjetër, në një cikël tjetër edukativo-arsimor ose në një shkollë tjetër nuk duhet të sjellë ndërprerjen e mbështetjes së ofruar deri në atë moment. Gjatë periudhave të tranzicionit hartohet një përmbledhje e shkurtër e zhvillimit të nxënësit, masave të zbatuara, përparimit të arritur dhe rekomandimeve përkatëse. Gjithashtu, përcaktohen personat përgjegjës për vazhdimin e mbështetjes, e cila përshtatet sipas kontekstit të ri arsimor.

VII.2. Parimet e vazhdimësisë

Ndjekja e vazhdueshme – zhvillimi i nxënësit dhe reagimi i tij ndaj mbështetjes përcillen gjatë gjithë shkollimit, ndërsa njohuritë e fituara shfrytëzohen për përshtatjen e saj.

Mbështetja e dokumentuar – njohuritë përkatëse, qëllimet e dakorduara zhvillimore dhe format e zbatuara të mbështetjes evidentohen në mënyrë të qartë dhe funksionale, në masën e nevojshme për vazhdimin e punës.

Rishqyrtimi periodik – plani i mbështetjes shqyrtohet në periudha të përcaktuara dhe detyrimisht gjatë ndryshimeve më të rëndësishme në rrugëtimin arsimor ose në nevojat zhvillimore të nxënësit.

Marrja e qartë e përgjegjësisë – gjatë çdo kalimi përcaktohen personat që vazhdojnë koordinimin, mbështetjen mësimore dhe përcjelljen.

Pjesëmarrja e nxënësit/nxënëses dhe familjes – nxënësi dhe prindërit, përkatësisht kujdestarët, informohen me kohë dhe, në përputhje me rolin e tyre, marrin pjesë në planifikimin e tranzicionit.

Përshtatshmëria dhe drejtësia – mbështetja nuk bartet në mënyrë mekanike, por përshtatet me mjedisin e ri dhe sigurohet pavarësisht statusit social, kulturor, gjuhësor ose statusit tjetër të nxënësit.

VII.3. Vazhdimësia gjatë arsimit fillor

Gjatë kalimit ndërmjet cikleve edukativo-arsimore, ekipi i shkollës përgjegjës për mbështetjen e nxënësve të talentuar dhe të dhuntishëm siguron bashkëpunimin ndërmjet mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë të ciklit paraprak dhe atyre të ciklit pasues. Në këtë proces shqyrtohen zhvillimi i nxënësit, interesat e tij, mënyra e të nxënit, përparimi i arritur, format e mbështetjes që kanë rezultuar të suksesshme, si dhe nevojat që vazhdojnë të jenë aktuale. Mësimdhënësit e rinj i shfrytëzojnë këto informacione për të siguruar vazhdimësinë dhe përshtatjen e mbështetjes gjatë procesit të rregullt mësimor dhe aktiviteteve të tjera edukativo-arsimore.

[26] Silverman, L. K. (1997). The construct of asynchronous development. *Peabody Journal of Education, 72*(3–4), 36–58. https://doi.org/10.1080/0161956X.1997.9681865

Vëmendje e veçantë i kushtohet kalimit nga mësimi klasor në mësimin lëndor, si dhe kalimit në ciklin e fundit edukativo-arsimor. Ndryshimi i numrit të mësimdhënësve, rritja e kërkesave arsimore dhe ndryshimet zhvillimore gjatë adoleshencës mund të ndikojnë në motivimin, mirëqenien dhe gatishmërinë e nxënësit për të shfaqur aftësitë e tij. Prandaj, monitorimi përfshin edhe aspektet socio-emocionale dhe marrëdhëniet me bashkëmoshatarët, kur këto janë të rëndësishme për procesin e të nxënit dhe zhvillimin e nxënësit.

VII.4. Kalimi në arsimin e mesëm

Përgatitja për kalimin në arsimin e mesëm fillon me kohë dhe ndërlidhet me orientimin profesional, interesat, aftësitë dhe qëllimet zhvillimore të nxënësit. Shkolla fillore e mbështet nxënësin dhe familjen në shqyrtimin e mundësive përkatëse arsimore dhe në marrjen e një vendimi të informuar, pa paracaktuar ose kufizuar zgjedhjen e tyre.

Në përputhje me kompetencat ligjore dhe dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale, shkolla siguron që informacionet përkatëse lidhur me zhvillimin e nxënësit dhe mbështetjen e ofruar deri në atë moment të jenë të disponueshme gjatë planifikimit të arsimimit të mëtejshëm. Bartja e informacionit realizohet me dijeninë dhe pjesëmarrjen e nxënësit dhe të prindërve, përkatësisht kujdestarëve ligjorë, në masën e nevojshme për sigurimin e vazhdimësisë së mbështetjes. Procedura përcaktohet më hollësisht në udhëzimet për vazhdimësinë, të paraqitura në Shtojcën 1, dokumenti 19, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

VII.5. Vazhdimësia e mbështetjes për nxënësit që përballen me rrezik më të madh për të mos u identifikuar

Gjatë tranzicioneve sigurohet vëmendje shtesë për nxënësit e ekspozuar ndaj rrezikut të mosidentifikimit, të përfshirë në kapitullin IV.4. Ndryshimi i mjedisit mund të ndërpresë mbështetjen e vendosur dhe ta fshehë sërish potencialin. Në rastin e dyfishimit të veçantisë, barten rekomandimet përkatëse si për zhvillimin e aftësive, ashtu edhe për qasshmërinë, duke përcaktuar qartë marrjen përsipër të përgjegjësive në mjedisin e ri. Shkolla verifikon në mënyrë aktive nëse masat e dakorduara kanë vazhduar dhe nëse u përgjigjen kushteve të reja.

VII.6. Rolet dhe përgjegjësitë

Drejtori siguron kushte organizative për marrjen përsipër të mbështetjes në kohë. Ekipi i shkollës ndërlidh personat që e dorëzojnë dhe ata që e vazhdojnë punën dhe inicion rishqyrtimin e masave. Mësimdhënësit përcjellin vëzhgimet pedagogjike dhe përshtatin mësimdhënien, ndërsa bashkëpunëtorët profesionalë mbështesin vlerësimin e nevojave të reja dhe orientimin profesional, në përputhje me rolet e përcaktuara në kapitullin VI.1.

Nxënësi në përputhje me moshën dhe pjekurinë, dhe prindërit/kujdestarët marrin pjesë në planifikimin e kalimit dhe japin informacione për interesat, nevojat dhe mirëqenien. BZHA-ja siguron udhëzime profesionale dhe mbështetje këshillimore për vazhdimësinë.

VII.7. Ndjekja e vazhdimësisë

Shkolla, në kuadër të procesit të vetëvlerësimit, shqyrton nëse mbështetja sigurohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë periudhave të kalimit, nëse përgjegjësitë janë marrë përsipër nga personat përkatës dhe nëse masat e ndërmarra u përgjigjen nevojave të reja. Gjetjet e këtij procesi shfrytëzohen për përmirësimin e udhëzimeve, burimeve dhe zhvillimit profesional, pa krijuar dokumentacion shtesë të panevojshëm.[27]

[27] Subotnik, R. F., Olszewski-Kubilius, P., & Worrell, F. C. (2011). Rethinking giftedness and gifted education: A proposed direction forward based on psychological science.

Psychological Science in the Public Interest, 12(1), 3–54. https://doi.org/10.1177/1529100611418056

VIII. NDJEKJA, VLERËSIMI DHE RAPORTIMI

Ndjekja, vlerësimi dhe raportimi janë pjesë përbërëse e zbatimit të Konceptit dhe shërbejnë për sigurimin e cilësisë, drejtësisë, vazhdimësisë dhe përmirësimit të sistemit të mbështetjes për nxënësit/nxënëset e talentuar dhe të dhuntishëm. Qëllimi i tyre nuk është vetëm evidentimi i aktiviteteve dhe arritjeve, por edhe përcaktimi nëse zgjidhjet e vendosura zbatohen, nëse mbështetja është e disponueshme, e përshtatshme dhe efektive, si dhe cilat ndryshime nevojiten në nivel të shkollës dhe të sistemit. Gjetjet kthehen në procesin e planifikimit dhe përbëjnë bazë për përshtatjen e mbështetjes, burimeve dhe zgjidhjeve sistemore.

Ndjekja realizohet në tri nivele të ndërlidhura ndërmjet tyre: zhvillimi dhe përparimi i nxënësit, zbatimi i Konceptit në shkollë dhe zbatimi dhe efektet e tij në nivel kombëtar. Njohuritë individuale orientojnë punën edukativo-arsimore nga kapitujt IV dhe V, ndërsa bashkimi i tyre në mënyrë përkatëse kontribuon në përcjelljen në nivel të shkollës dhe të sistemit.

Ndjekja përfshihet në proceset ekzistuese të planifikimit, vetëvlerësimit, planifikimit zhvillimor dhe përcjelljes profesionale. Të dhënat ekzistuese shfrytëzohen për disa qëllime të përcaktuara dhe të arsyetuara paraprakisht, vetëm kur kjo është në përputhje me qëllimin, qasjen e lejuar dhe dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale. Nuk krijohet sistem paralel administrativ, ndërsa vëllimi dhe hollësitë e të dhënave janë në përpjesëtim me qëllimin e ndjekjes.

VIII.1. Korniza dhe treguesit për ndjekje

Zbatimi i Konceptit ndiqet apo monitorohet përmes një grupi të kufizuar dhe funksional treguesish sasiorë dhe cilësorë. Para fillimit të zbatimit të plotë përcaktohet gjendja fillestare, me qëllim që të mundësohet vlerësimi i përparimit gjatë kohës. Treguesit përfshijnë kushtet dhe burimet, proceset, rezultatet e drejtpërdrejta dhe efektet zhvillimore, si dhe mundësojnë vlerësimin e përfshirjes, cilësisë, qasjes dhe drejtësisë në ofrimin e mbështetjes.

Në nivel individual të nxënësit, në bazë të qëllimeve individuale, fushës së potencialit dhe nevojave arsimore, përzgjidhen treguesit përkatës për vlerësimin e përparimit drejt arritjes së qëllimeve zhvillimore, cilësisë dhe kompleksitetit të punës, pavarësisë, kreativitetit, motivimit, zbatimit të njohurive të përvetësuara, reagimit ndaj sfidave të ofruara dhe vazhdimësisë së mbështetjes. Mirëqenia monitorohet kur është e rëndësishme për procesin e të nxënit dhe zhvillimin e nxënësit.

Te nxënësit me veçori të dyfishta, shqyrtohen në mënyrë të ndërlidhur përparimi në fushën e potencialit, zvogëlimi i pengesave, pjesëmarrja dhe mirëqenia. Përmirësimi në njërën fushë nuk e zëvendëson monitorimin e fushës tjetër. Notat, shpërblimet dhe rezultatet në gara përbëjnë pjesë të dëshmive vlerësuese, por nuk përfaqësojnë treguesit e vetëm. Të dhënat individuale mbrohen në përputhje me shkallën e ndjeshmërisë së tyre, ndërsa në raportimin në nivel shkolle dhe sistemi përdoren të dhëna të agreguara ose të anonimizuara. Monitorimi në nivel shkolle përfshin fushat e mëposhtme, nga të cilat në kuadër të kornizës kombëtare përcaktohet një grup bazë dhe i kufizuar treguesish:

- njohjen, përfshirjen dhe qasjen e drejtë në mbështetje, duke përfshirë edhe nxënësit/nxënëset me potencial të fshehur dhe me dyfishim të veçantisë;
- organizimin e punës ekipore, disponueshmërinë e burimeve dhe aftësimin profesional të kuadrit;
- zbatimin dhe përshtatjen e masave në mësimdhënie, planifikimin individual dhe mentorimin;
- pjesëmarrjen dhe përvojat e nxënësve/nxënëseve dhe prindërve/kujdestarëve, si dhe vazhdimësinë e mbështetjes gjatë kalimit;
- përparimin në raport me qëllimet individuale, vështirësitë e evidentuara dhe nevojat për avansim.

Në nivel sistemik monitorohen përfshirja dhe shpërndarja rajonale, dallimet në zbatimin e masave ndërmjet shkollave, disponueshmëria e burimeve profesionale dhe materiale, zbatimi i protokolleve dhe instrumenteve, nevojat për zhvillim profesional, si dhe efektet e masave sistemike. Kur është e arsyeshme, të dhënat ndahen sipas kritereve përkatëse për vlerësimin e barazisë dhe drejtësisë, duke zbatuar njëkohësisht masa mbrojtëse që parandalojnë identifikimin ose riidentifikimin e nxënësve, përfshirë edhe rastet e kombinimit të të dhënave për grupe të vogla ose shkolla të veçanta.

Byroja e Zhvillimit të Arsimit (BZHA), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH), shkollat dhe institucionet përkatëse profesionale, harton kornizën kombëtare për ndjekje apo monitorim dhe vlerësim. Në këtë kuadër, përcakton dallimin ndërmjet grupit bazë të treguesve shkollorë dhe treguesve sistemikë, si dhe definicionet, burimet dhe cilësinë e të dhënave, metodologjinë e llogaritjes, vlerat fillestare dhe ato të synuara, periodicitetin, përgjegjësitë dhe format e raportimit.

Në masën më të madhe të mundshme, shfrytëzohen burimet dhe proceset ekzistuese, ndërsa çdo mbledhje e re e të dhënave realizohet vetëm kur është e domosdoshme dhe e mbështetur në aktet përkatëse normative. Zbatueshmëria e kornizës dhe ngarkesa administrative vlerësohen gjatë fazës së pilotimit.

VIII.2. Ndjekja dhe vetëvlerësimi në nivel shkolle

Shkolla e ndjek zbatimin e Konceptit në kuadër të planifikimit dhe vetëvlerësimit të rregullt. Ekipi i shkollës përgatit një pasqyrë të shkurtër periodike të masave të realizuara, disponueshmërisë dhe efekteve të mbështetjes, funksionimit të punës ekipore dhe asaj mentoruese, nevojave të nxënësve dhe të punësuarve, si dhe sfidave të identifikuara. Pasqyra përfshihet në raportet ekzistuese të shkollës, nuk përmban të dhëna personale të panevojshme dhe nuk përbën evidencë paralele pedagogjike.

Gjatë vetëvlerësimit shqyrtohet nëse nxënësit/nxënëset me potencial të lartë identifikohen me kohë; nëse mbështetja ndërlidhet me profilin e tyre individual; nëse mësimi i rregullt ofron sfida të përshtatshme; nëse mundësitë jashtëshkollore janë të qasshme në kushte të drejta; dhe nëse masat e zbatuara kontribuojnë në përparimin dhe mirëqenien e tyre.

Në veçanti, analizohet nëse në mesin e nxënësve të njohur, të identifikuar dhe të mbështetur përfaqësohen nxënës nga mjedise të ndryshme, si dhe nëse identifikohen nxënësit, aftësitë e larta të të cilëve nuk shoqërohen me rezultate të larta shkollore. Të dhënat nuk përdoren për përcaktimin e kuotave, por për evidentimin e paragjykimeve të mundshme, pengesave dhe pabarazive në qasjen ndaj mundësive arsimore.

Njohuritë e përfituara nga procesi i ndjekjes apo monitorimit dhe vetëvlerësimit shfrytëzohen për përmirësimin e procesit mësimor, punës së ekipit të shkollës, ofertës së aktiviteteve, zhvillimit profesional, partneriteteve dhe shpërndarjes së burimeve. Përmirësimet e nevojshme përfshihen në programin zhvillimor dhe në programin vjetor të punës së shkollës.

Drejtori siguron kushtet e nevojshme për mbledhjen dhe shqyrtimin e të dhënave, si dhe për zbatimin e përmirësimeve të dakorduara. Koordinatori dhe ekipi i shkollës bashkërendojnë njohuritë përkatëse, pa pasur qasje në të dhënat që nuk janë të nevojshme për ushtrimin e përgjegjësive të tyre. Organet dhe strukturat profesionale shqyrtojnë gjetjet në përputhje me kompetencat e tyre.

VIII.3. Ndjekja dhe vlerësimi në nivel sistemik

Byroja e Zhvillimit të Arsimit, në kuadër të kompetencave të saj, koordinon komponentin profesional dhe zhvillimor të ndjekjes sistemike, analizon gjetjet nga zbatimi, përgatit raportin profesional kombëtar dhe propozon masa për përmirësim. Ministria e Arsimit dhe Shkencës e shqyrton raportin, i shfrytëzon njohuritë e fituara për planifikimin e politikave dhe zgjidhjeve normative e financiare, si dhe siguron koordinimin me institucionet e tjera kompetente. Në vlerësimin periodik, kur kjo është e nevojshme për të garantuar ekspertizën dhe paanshmërinë e tij, përfshihen institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet shkencore, institucionet e tjera kompetente dhe ekspertë të pavarur.[28]

Ndjekja sistemike bazohet në treguesit e përcaktuar, të dhënat dhe njohuritë e fituara nga shkollat, rezultatet e vetëvlerësimit, puna profesionale dhe këshillëdhënëse, si dhe hulumtimet dhe vlerësimet periodike. Shfrytëzohen vetëm të dhënat në masën e nevojshme për qëllimin e përcaktuar, duke respektuar konfidencialitetin, etikën profesionale dhe dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.[29]

Vlerësimi periodik shqyrton relevancën dhe qëndrueshmërinë e sistemit të vendosur, si dhe kushtet që lehtësojnë ose kufizojnë zbatimin e tij. Në të përfshihen përvojat e nxënësve/nxënëseve, prindërve, përkatësisht kujdestarëve, mësimdhënësve/mësimdhënëseve, bashkëpunëtorëve profesionalë, drejtorëve/drejtoreshave dhe partnerëve të jashtëm. Dinamika dhe përfshirja përcaktohen me kornizën për përcjellje dhe vlerësim, ndërsa pas ndryshimeve më të rëndësishme sistemike mund të realizohet edhe vlerësim tematik.

Përveç numrit të nxënësve/nxënëseve të njohur dhe të identifikuar, vlerësimi shqyrton cilësinë dhe larminë e mbështetjes, përparimin dhe mirëqenien e nxënësve/nxënëseve, funksionalitetin e procedurave, drejtësinë në qasje, nevojat profesionale dhe ato për burime, si dhe dallimet ndërmjet shkollave dhe mjediseve. Treguesit sasiorë interpretohen së bashku me të dhënat cilësore dhe nuk përdoren për renditjen mekanike të shkollave.

Rezultatet shërbejnë si bazë për përmirësimin e protokolleve, instrumenteve, udhëzimeve profesionale, programeve për zhvillim profesional, mekanizmave të mbështetjes dhe sistemit të financimit, si dhe për propozimin e ndryshimeve normative kur konstatohet nevoja për to. Për rekomandimet e pranuara përcaktohen bartësit, prioritetet dhe afatet për veprim, ndërsa realizimi i tyre përcillet në ciklin vijues.

[28] Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. (2006). *Ligji për Byronë për Zhvillimin e Arsimit.* "Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 37/2006, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2019). *Ligji për arsimin fillor.* "Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 161/2019, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme.

[29] Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2020). *Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale.* "Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 42/2020, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Zbatohen edhe dispozitat që rregullojnë dokumentacionin dhe evidencën pedagogjike në arsimin fillor.

VIII.4. Raportimi kombëtar dhe shfrytëzimi i rezultateve

Në bazë të përcjelljes kombëtare dhe vlerësimit periodik përgatiten raporte për zbatimin e Konceptit. Raportet japin një pasqyrë të gjendjes fillestare dhe ndryshimeve të arritura, dallimeve në qasshmëri dhe cilësi, sfidave të identifikuara, masave të ndërmarra dhe rekomandimeve për zhvillimin e mëtejshëm. Në përputhje me dispozitat, sigurohet një pasqyrë e gjetjeve kryesore, e qasshme për publikun.

Raportimi duhet të jetë proporcional dhe i orientuar drejt marrjes së vendimeve. Në raportet publike paraqiten të dhëna të agreguara dhe gjetje që nuk mundësojnë identifikimin e nxënësit/nxënëses. Të dhënat e hollësishme profesionale shfrytëzohen vetëm nga personat dhe institucionet kompetente dhe ekskluzivisht për qëllimin e përcaktuar.

Informimi i publikut kontribuon në kuptimin e mënyrave të ndryshme të manifestimit të potencialit dhe të qasshmërisë së mbështetjes. Prezantimet shkollore dhe publike, aktivitetet krijuese dhe takimet me familjet mund të planifikohen në programet vjetore, duke respektuar dinjitetin, privatësinë dhe pjesëmarrjen vullnetare të nxënësve/nxënëseve.

Zbatimi planifikohet në mënyrë graduale. Në fazën përgatitore, MASH-i dhe BZHA-ja përcaktojnë paketën fillestare të dokumenteve dhe kushtet për pilotim sipas Shtojcës 1. Sigurohen përgjegjësi të qarta, baza e nevojshme normative, burimet, trajnimi dhe mbështetja profesionale për procedurat që do të zbatohen. Vlerësimi i specializuar realizohet me instrumente përkatëse dhe nga persona të kualifikuar. Gatishmëria e shkollave verifikohet sipas kritereve të përcaktuara, ndërsa burimet dhe dokumentet e tjera zhvillohen në fazat e përcaktuara.

Pilotimi përfshin protokolet kryesore, instrumentet, formularët dhe zgjidhjet organizative në shkolla me madhësi të ndryshme, gjuhë të ndryshme mësimore, kontekste të ndryshme gjeografike dhe sociale, si dhe kapacitete të ndryshme profesionale. Verifikohen zbatueshmëria, drejtësia, shpenzimet, ngarkesa administrative dhe efektet në mbështetjen e nxënësve/nxënëseve. Gjetjet shfrytëzohen për rishikim dhe për marrjen e vendimit për zgjerim gradual.

MASH-i dhe BZHA-ja, në kuadër të kompetencave të tyre, përcaktojnë bartësit, dinamikën dhe kushtet për kalimin ndërmjet fazave. Mbështetja bazë në mësimdhënie vazhdon edhe gjatë përgatitjes dhe pilotimit. Zgjerimi i mëvonshëm ndërlidhet me sigurimin e kapaciteteve, mbështetjen e vazhdueshme profesionale dhe vlerësimin periodik.

SHTOJCA 1. DOKUMENTET SHOQËRUESE PËR ZBATIMIN E KONCEPTIT

Pasqyra përmbledh dokumentet, instrumentet, formularët dhe udhëzimet që duhet të përgatiten ose të harmonizohen pas miratimit të Konceptit. Ato e shtjellojnë zbatimin e sistemit të përcaktuar dhe përgatiten në kuadër të kompetencave të institucioneve. Çështjet që krijojnë të drejta, detyrime, autorizime ose detyrime financiare të reja rregullohen me akte përkatëse para zbatimit të tyre.

Numrat shërbejnë për referim nga kapitujt dhe nuk nënkuptojnë 25 akte të veçanta. Përmbajtjet bashkohen në shtatë paketa të ndërlidhura: zbatimi dhe burimet; njohja dhe identifikimi; puna edukativo-arsimore; organizimi ekipor, dokumentacioni dhe vazhdimësia; kompetencat dhe zhvillimi profesional; përcjellja dhe raportimi; burimet e përbashkëta profesionale.

Fazat në pasqyrë shënojnë dinamikën e përgatitjes dhe zbatimit: I – përgatitja, rregullimi plotësues normativ dhe sigurimi i burimeve; II – pilotimi, vlerësimi dhe rishikimi; III – zgjerimi gradual, mbështetja e vazhdueshme dhe përditësimi. Afatet konkrete dhe bartësit përcaktohen me planin e zbatimit. Dokumenti i shënuar me disa faza zhvillohet dhe përmirësohet gjatë këtyre fazave.

Paketa fillestare për pilotim përfshin pjesët e zbatueshme të protokollit kombëtar dhe formularët bazë për vëzhgim, iniciativë, profil dhe rishqyrtim (dokumentet 2–9); udhëzimet për dyfishësinë e veçantisë, punën mësimore dhe planifikimin (10–12); rregullat për koordinimin ekipor dhe të dhënat (17–18); si dhe trajnimin dhe përcjelljen e nevojshme (21–23). Përfshirja, versionet, personat përgjegjës dhe burimet e siguruara përcaktohen me planin e zbatimit (1). Për çdo procedurë të specializuar verifikohen parakushtet e saj konkrete. Përgatitja e të gjithë pasqyrës nuk është kusht për fillimin e mbështetjes bazë në mësimin e rregullt.

Testet e licencuara, detyrat e testeve dhe protokollet individuale psikologjike nuk publikohen si shtojca publike. Në dokumentet publike përcaktohen qëllimi i tyre, kushtet e zbatimit dhe personat profesionalë kompetentë; materialet sigurohen dhe ruhen në përputhje me kushtet profesionale dhe ligjore.

Tabela 1. Pasqyra e unifikuar e dokumenteve dhe shtojcave

Dokumenti	Kapitulli Faza
1 Plani i zbatimit dhe burimet Fazat, afatet, rezultatet, nevojat për personel dhe materiale, shpenzimet dhe burimet e financimit. Pasqyra e rregullimit plotësues normativ të nevojshëm, gatishmërisë së shkollave dhe kushteve për mbështetje bazë falas në shkollë. Shtojca me përgjegjësitë dhe dinamikën. Vlerësimi i kohës së punës, normimit dhe vlerësimit të angazhimit shtesë.	VIII.4 I–III
2 Protokolli kombëtar për njohjen dhe identifikimin Zhvillimi dhe përcjellja, inicimi i vlerësimit profesional, burimet e dëshmive, integrimi i gjetjeve, vendimmarrja dhe nënshkrimi, afatet dhe rishqyrtimi. Veprimi në rast të gjetjeve të ndryshme, mospajtimit, refuzimit ose mungesës së kapaciteteve profesionale.	IV VI.1 I–II

Dokumenti	Kapitulli Faza
3 Udhëzime dhe formularë për vëzhgimin gjatë mësimdhënies Lista të treguesve, shënime nga vëzhgimi, shkallë vlerësimi që plotëson mësimdhënësi/mësimdhënësja, analiza e produkteve dhe detyrave të nxënësit/nxënëses, biseda dhe përcjellja e reagimit ndaj të nxënit të pasuruar. Shembuj sipas fushave dhe periudhave zhvillimore, me verifikimin e paragjykimeve dhe qasshmërisë.	IV.3–4 I–II
4 Formularë për nominim dhe iniciativë Formularë të shkurtër për iniciativë nga mësimdhënësi/mësimdhënësja, prindi ose kujdestari dhe vetënominim nga nxënësi/nxënësja; informacione nga burime të tjera përkatëse. Konfirmimi i pranimit, shqyrtimit dhe informata kthyese me arsyetim. Nominimi inicion shqyrtimin e nevojave dhe dëshmive.	IV.2–3 I–II
5 Matrica e kritereve dhe dëshmive Fushat e potencialit dhe arritjeve, periudhat zhvillimore, burimet përkatëse dhe mënyrat e kombinimit të tyre. Potenciali i fshehur dhe arritjet nën nivelin e pritshëm. Garat, notat dhe testet individuale shqyrtohen si pjesë e materialit më të gjerë dëshmues.	II IV.3–4 I–II
6 Korniza për përzgjedhjen dhe zbatimin e instrumenteve Kriteret për përzgjedhjen e instrumenteve për aftësitë intelektuale, kreativitetin, motivimin, interesat dhe fushat specifike, sipas qëllimit dhe profilit. Përshtatja, verifikimi i vlefshmërisë dhe besueshmërisë, normat dhe kufizimet përkatëse; kualifikimet, trajnimi, lejet për përdorim dhe ruajtja profesionale. Përfshirja dhe kushtet për zbatimin e testeve të standardizuara të njohurive.	IV.3–5 VI.2 I–II
7 Analiza dhe modeli për mbështetjen e jashtme profesionale Nevojat dhe mundësitë për realizimin e kapaciteteve kombëtare psikometrike dhe mbështetjes rajonale ose universitare. Funksionet sistemike të ndara për instrumentet, trajnimin dhe mbikëqyrjen profesionale, si dhe bashkëpunimi për nxënësin/nxënësen konkret/e. Qasshmëria, referimi i orientuar, rekomandimet kthyese për mësimdhënien, mendimi i dytë, financimi dhe përgjegjësia.	IV.5 VI.1–2 I–III
8 Formulari për profilin individual dhe raportin profesional Ndërlidhja e njohurive pedagogjike dhe të specializuara, anët e forta, interesave, nevojave dhe kufizimeve të gjetjeve. Rekomandime për qëllimet, ndërlikueshmërinë e detyrave, ritmin, metodat dhe qasshmërinë. Përfundim profesional i arsyetuar, nënshkrime profesionale dhe afati për rishqyrtim.	IV.3–5 VI.1 I–II
9 Procedura për mendimin e dytë dhe rishqyrtimin Kërkesa, personi ose institucioni kompetent, dokumentet e nevojshme, afatet, përgjigjja e arsyetuar dhe vazhdimi i mbështetjes bazë shkollore. Referimi në rast të mungesës së kapaciteteve ose të gjetjeve të ndryshme. Formularë bashkëngjitur për kërkesën, referimin dhe raportin profesional kthyes.	IV.5 VI.1 I–II
10 Udhëzime për dyfishësinë e veçantisë dhe vlerësimin e qasshëm Mbivendosja dhe fshehja e ndërsjellë e potencialit dhe vështirësive; vlerësimi i qasshëm i profilit të pabarabartë, rishqyrtimi dhe referimi. Diferencimi i dyfishtë, shembuj të përshtatjeve dhe teknologjia ndihmëse. Koordinimi i ekipeve, ndërlidhja me PIA-n kur është e zbatueshme dhe përcjellja e përbashkët e zhvillimit dhe pengesave. Pengesat gjuhësore dhe ato që lidhen me mjedisin trajtohen veçmas nga dyfishësia e veçantisë.	II.5 IV.4 V.2 и V.5 VI.1 VIII.1 I–II
11 Udhëzime dhe shembuj për punën edukativo-arsimore Diferencimi, individualizimi, pasurimi, thellimi, ritmi fleksibil, puna me projekte dhe hulumtuese. Verifikimi i përvetësimit të njohurive para zvogëlimit të përsëritjeve. Shembuj të shtjelluar për ndërlidhjen e profilit, qëllimeve zhvillimore, planifikimit, detyrave, vlerësimit formativ dhe rishikimit të masave në fusha të ndryshme dhe kushte të ndryshme shkollore.	V.1–4 I–II


Dokumenti	Kapitulli Faza
12 Planifikimi i shkurtër dhe plani individual për mbështetje Formular i shkurtër për masat fillestare dhe plan i zgjeruar sipas ndërlikueshmërisë dhe kohëzgjatjes. Qëllimet, aktivitetet, personat përgjegjës, burimet, treguesit, pjesëmarrja e nxënësit/nxënëses dhe rishikimi. Shembuj të plotësuar; harmonizimi me PIA-n kur është i zbatueshëm, me status të dalluar juridik dhe shfrytëzim të të dhënave të përbashkëta pa dyfishim.	IV.5 V.5 VI.1 I–II
13 Udhëzime për mbështetjen këshillëdhënëse dhe socio-emocionale Aktivitete parandaluese dhe këshillim i orientuar sipas nevojave; mirëqenia, motivimi, marrëdhëniet me shokët/shoqet e klasës dhe bashkëpunimi me familjen. Ndarja e qartë e roleve profesionale, udhëzime për referim dhe përcjellje e shkurtër e efekteve. Materiale për informim dhe punëtori me prindërit.	V.5 VI.1 I–II
14 Udhëzime për mentorimin dhe bashkëpunimin e jashtëm Kompetencat dhe përzgjedhja e mentorëve, qëllimet, plani, mbikëqyrja, përgjegjësia dhe koordinimi me mësimdhënien. Model-marrëveshje me mbrojtjen e fëmijës, konfidencialitetin, kompensimin, të drejtat mbi produktet e krijuara dhe ndërprerjen. Qasje për shkollat e vogla dhe rurale, përfshirë format përkatëse të bashkëpunimit në distancë. Model i rrjetit të mentorimit ndërmjet shkollave, në nivel rajonal dhe kombëtar.	V.3–5 VI.1 I–II
15 Udhëzim profesional për përparimin e përshpejtuar Kushtet dhe kriteret për format e lejuara, vlerësimi individual, pjesëmarrja e nxënësit/nxënëses dhe familjes, vendimi, përgatitja dhe përcjellja. Formularë për planin dhe pasqyrën periodike. Çdo formë zbatohet pas sigurimit të parakushteve të nevojshme normative dhe profesionale.	V.6 VII I–III
16 Udhëzime për garat dhe mbështetjen materiale Përgatitja dhe pjesëmarrja në gara, duke pasur parasysh drejtësinë, mirëqenien dhe qasshmërinë. Informacione për shpërblimet, bursat dhe mundësitë e tjera sipas programeve dhe konkurseve të zbatueshme. Rolet e shkollës dhe partnerëve dhe përditësimi i rregullt i informacioneve. Vlerësimi i mundësisë për realizimin e mini-bursave dhe vaučerëve, pa krijuar automatikisht të drejtë.	V.4 и V.7 I–III
17 Udhëzime për ekipin e shkollës dhe koordinimin Një bërthamë e vogël koordinuese dhe përbërje e përshtatshme; përzgjedhja e koordinatorit/koordinatores, detyrat dhe orari i punës. Ndërlidhja me ekipet gjithëpërfshirëse dhe personin përgjegjës për komunikim. Model i aktit, procesverbal i shkurtër dhe rregulla për vendimmarrjen, kompetencat profesionale, konfidencialitetin, konfliktin e interesit dhe mospajtimin.	IV.3 VI.1 I–II
18 Portofoli dhe rregullat për dokumentacionin dhe të dhënat Strukturë minimale, regjistrim vetëm një herë dhe ndërlidhje me evidencat ekzistuese. Formularë për informim dhe pëlqim kur është i nevojshëm; baza juridike, qasja, shkëmbimi, afatet e ruajtjes dhe arkivimi. Ruajtja e veçantë e protokolleve psikologjike dhe materialeve të licencuara. Raportimi i agreguar me mbrojtje nga riidentifikimi.	IV.5 VI.3 VII–VIII I–II
19 Udhëzime dhe formular për vazhdimësinë e mbështetjes Kalimi ndërmjet klasave, nga mësimi klasor në atë lëndor, ndërmjet shkollave dhe në arsimin e mesëm. Përmbledhje e shkurtër pedagogjike, pjesëmarrja e nxënësit/nxënëses dhe familjes, personat përgjegjës, koordinimi dhe vazhdimi i masave. Bartja e informacioneve të domosdoshme sipas rregullave për të dhënat.	VII VI.3 I–II
20 Pasqyra dhe plotësimi i kompetencave profesionale Matrica e kompetencave ekzistuese dhe plotësimeve të nevojshme për mësimdhënësit/mësimdhënëset, bashkëpunëtorët profesionalë, drejtorët/drejtoreshat, koordinatorët/koordinatoret dhe mentorët. Lidhja me arsimin fillestar dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional. Propozime për plotësimin e standardeve dhe akteve përkatëse aty ku konstatohet nevoja.	VI.2 I–III

Dokumenti	Kapitulli Faza
21 Programet dhe materialet për zhvillim profesional Module bazë dhe të avancuara, detyra praktike, analiza të rasteve dhe përcjellja e zbatimit, përfshirë edhe për potencialin e fshehur dhe dyfishësinë e veçantisë. Programe për trajnues, mbështetje mentoruese dhe aftësim të specializuar për instrumentet. Akreditimi, katalogu përkatës dhe përditësimi sipas kornizës së zbatueshme.	VI.2 I–III
22 Korniza kombëtare për përcjellje dhe vlerësim Grup i kufizuar bazë i treguesve shkollorë dhe sistemikë; vlerat fillestare, burimet, përgjegjësitë dhe periodiciteti. Formularë të shkurtër për përparimin, efektet, qasshmërinë dhe drejtësinë; përvojat e nxënësve/nxënëseve, prindërve dhe personelit. Harmonizimi me proceset ekzistuese të vetëvlerësimit.	IV.5 V.9 VIII.1–4 I–III
23 Protokolli për pilotim dhe vlerësimin e gatishmërisë Përzgjedhja e mjediseve të ndryshme shkollore. Verifikimi i paketës fillestare, përgjegjësive, kushteve ligjore, personelit, instrumenteve, trajnimit, burimeve dhe mbrojtjes së të dhënave. Përcjellja e zbatueshmërisë, drejtësisë, shpenzimeve dhe ngarkesës administrative; kriteret për rishikim dhe zgjerim gradual.	VIII.4 I–II
24 Metodologjia dhe formularët për raportimin sistemik Pasqyra periodike e shkollës, raporti profesional kombëtar dhe përmbledhja publike. Të dhëna të agreguara, analiza e efekteve dhe dallimeve, rekomandime dhe plan për përmirësim. Ndërlidhja me vendimet për burimet, trajnimet, instrumentet dhe ndryshimet normative.	VIII.2–4 I–III
25 Përmbledhja e burimeve dhe mënyra e përditësimit të tyre Vend i vetëm për udhëzimet, formularët, shembujt dhe materialet e miratuara për trajnim, me versionin dhe datën përkatëse. Rregulla për verifikimin profesional, qasshmërinë, informatat kthyese dhe përditësimin. Instrumentet konfidenciale dhe të licencuara kanë qasje të veçantë të kontrolluar.	V.9 VI.2–3 VIII.4 I–III

PARAQITJA GRAFIKE E PROCESIT TË PLOTË

Paraqitja grafike 3. Ndërlidhja e përgatitjes, punës në shkollë dhe avansimin e sistemit

Grafiku 3. Ndërlidhja e përgatitjes, punës shkollore dhe përmirësimit të sistemit



Paraqitja tregon ndërlidhjen e proceseve. Mbështetja bazë shkollore fillon me njohjen dhe vazhdon pavarësisht nevojës për identifikim formal. Mbështetja e jashtme profesionale sigurohet sipas nevojave dhe kushteve të përcaktuara, ndërsa përcjellja çon drejt rivlerësimit dhe përshtatjes.